

ARSYET E KTHIMIT

TË LIGJIT NR. 50/2022

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ADMINISTRIMIN E NËNZONAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE PEIZAZHIT KULTUROR, PJESË E PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT, NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS DHE FONDACIONIT PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT”

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 23 maj 2022, ka miratuar ligjin nr. 50/2022 “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

Ky ligj me shkresën me nr. 2053 prot., datë 2.06.2022, të Kuvendit, i është përcjellë Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje.

Sipas praktikës parlamentare, ky akt para miratimit është shqyrtuar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit (26 prill 2022), Komisionin për Politikën e Jashtme (10 maj 2022), Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (13 maj 2022) në cilësinë e komisioneve për dhënie mendimi, si dhe në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, si komisioni përgjegjës (17 maj 2022).

Ky ligj, ashtu siç dhe citohet në relacionin shoqëruar të nismës, synon miratimin e marrëveshjes së administrimit ndërmjet një fondacioni të posaçëm dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, për një pasuri kulturore me rëndësi universale si Parku Kombëtar i Butrintit, duke përcaktuar në këtë marrëveshje mes të tjerash afatin, dhe kushtet e veçanta për administrimin e saj, ndërkohë që vetë marrëveshja e administrimit të pasurisë kulturore të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit **është nënshkruar që prej datës 16.11.2021**, ndërmjet Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe Ministrisë së Kulturës. Fondacioni i posaçëm i krijuar, themeluar dhe regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 22.07.2021, ka si themelues Ministrinë e Kulturës së Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.

Projektligji për miratimin e kësaj marrëveshjeje, është depozituar në Kuvend rreth 5 muaj më pas, vetëm në datën **7.04.2022**¹, moment ky prej të cilit nisi dhe debati publik mbi këtë nismë, që do të duhet t’i ishte nënshtruar shqyrtimit, diskutimit dhe konsultimit të gjerë publik në nivel ekspertësh,

¹ Për më shumë: <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/55724>

akademikësh e historianësh, që prej fazës fillestare të projekt idesë dhe identifikimit të nevojës për një marrëveshje të kësaj natyre për mënyrën e administrimit të një pasurie kulturore me vlera universale.

Nga shqyrtimi paraprak i praktikës parlamentare, rezultoi se një proces i tillë konsultimi gjithëpërfshirës i ka munguar këtij procesi që në gjenezën e tij. Kjo mund të ketë bërë që shumë prej çështjeve që sot janë pjesë e dyshimit dhe debatit publik, mund të ishin shteruar përmes zgjidhjeve të përshtatshme dhe transparencës maksimale sa i takon vendimmarrjes mbi mënyrën e administrimit të Parkut të Butrintit.

Në procese të tilla ku bëhet fjalë për pasuri pronë publike të patjetërsueshme dhe nga më të rëndësishmet që përfaqësojnë identitetin tonë kombëtar, transparenca dhe konsultimi janë themelore, e duhet të shoqërojnë procesin në çdo hap, që prej lindjes së projekt ideve. Në këto procese konsultimi, nuk duhet të shmangen as zërat kundër apo objektivë, në konsultat apo sugjerimet e tyre. Vetëm përmes një procesi të këtillë, ku debati historik e shkencor duhet të shterojë që në fazat fillestare, vendimmarrja do të rezultonte më e gjithëpranuar.

Presidenti i Republikës ka ndjekur me vëmendje të gjithë këtë debat publik dhe shqetësimet e ekspertëve, por edhe të aktorëve të ndryshëm për këtë nismë, është njohur me mendimet, vërejtjet dhe vlerësimet mbi nismën, që do të duhet të ishin shqyrtuar me kujdesin e duhur jo vetëm së fundmi nga ana e Kuvendit, por edhe nga vetë Qeveria përgjatë fazës përgatitore të saj.

Jo vetëm që ky proces bashkëpunimi në nivel ekzekutiv u konstatua me të meta gjatë debatit në Kuvendin e Shqipërisë, por ky i fundit rezultoi se nuk e ka ushtruar pushtetin e tij të kontrollit ndaj ekzekutivit, duke pranuar *a priori* zgjidhjet që qeveria ka propozuar, pa ndryshim.

Nëse Kuvendi do të kishte treguar më shumë kujdes, duke qenë se bëhet fjalë për një pasuri ku mishërohen vlerat kombëtare të mbrojtura që në Preambulën e Kushtetutës, kishte dy mundësi zgjidhjeje: ose të riparonte të gjitha të metat përgjatë procesit parlamentar, ose të kthente propozimin pranë Qeverisë me rekomandimet konkrete për adresim.

Për më tepër, përgjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet parlamentare, veçanërisht është kërkuar nga deputetë kryerja e dëgjësive të ekspertëve dhe akademikëve, por Kuvendi i ka anashkaluar këto kërkesa dhe nuk i ka trajtuar siç serioziteti i kësaj çështjeje dikton.

Në këtë fazë, Presidenti i Republikës, si pjesë e procesit fundor legjislativ, gjatë vlerësimit të këtij ligji, duke qenë se ka konstatuar mos përmbushjen e detyrimeve prej Kuvendit, dhe me qëllimin që administrimi i një pasurie me vlera kulturore universale të bëhet në përputhje të plotë me interesin publik kombëtar, e që të garantojë mbrojtjen dhe zhvillimin pa asnjë ekuivok të kësaj pasurie, Presidenti nuk mund të dekretojë me shpallje këtë ligj e bashkë me të dhe marrëveshjen pjesë e tij, por si një mundësi e fundit, ka vendosur ta kthejë për

rishqyrtim, me qëllim plotësimin e rekomandimin për gjetjen e zgjidhjeve më të mira në këtë rast.

Kthimi për rishqyrtim duhet të vlerësohet me shumë objektivitet nga ky Kuvend, referuar arsyeve pse ky ligj kthehet, por edhe të dokumenteve bashkëlidhur këtij arsyetimi, që evidentojnë të dhëna, fakte, vlerësime, apo edhe dyshime të aktorëve me peshë të shoqërisë civile, ekspertëve të arkeologjisë, anëtarëve të botës akademike, apo dhe vetë ish anëtarëve të organizmave me të cilat shteti ka vendosur të bashkëpunojë.

Këto të dhëna e vlerësime, hedhin dritë mbi procesin e ndjekur e që Kuvendi, si përfaqësues i sovranit (popullit), duhet detyrimisht t'i marrë në analizë në respektim të nevojës për transparencë dhe vendimmarrjes në përputhje me interesin kombëtar.

Përpos sa më sipër, Presidenti i Republikës ka konstatuar se, edhe për arsye të tjera që shtjellohen në vijim të këtij arsyetimi, procesi legjislativ që ka çuar në miratimin e kësaj marrëveshjeje objekt shqyrtimi, e cila:

- **cenon dispozita konkrete të Kushtetutës dhe parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës;**
- **cenon parimet dhe vlerat universale që mbrohen që në preambulën e Kushtetutës, duke cenuar kështu drejtpërdrejtë interesin publik shqiptar;**
- **cenon Konventën e Parisit dhe nuk është në harmoni me parimet e mbrojtura nga UNESCO;**
- **bie ndesh me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese;**
- **praktika e ndjekur nga ekzekutivi dhe Kuvendi i Shqipërisë, rezulton se nuk ka realizuar dhe nuk ka siguruar mendimin e ekspertizës së pavarur vendase që ka njohuri të thelluara mbi Parkun Kombëtar të Butrintit, nënzonave dhe siteve arkeologjike të tij;**
- **procedura e ndjekur nuk ka garantuar një proces të gjerë e të thelluar të konsultimit me publikun, duke sjellë kështu një produkt jo cilësor dhe një debat publik mbi këtë çështje;**
- **shmang auditimin përmes institucioneve të pavarura kushtetuese të veprimtarisë ekonomike-financiare lidhur me të ardhurat që do të krijohen dhe mënyrën e përdorimit të tyre;**
- **për shkak të mungesës së konsultimit gjithëpërfshirës, ky ligj është produkt i një procesi që ka shkelur Rezolutën e datës 19 maj 2022, të miratuar nga Parlamentit Evropian².**

Detyra e Presidentit të Republikës si përfaqësues i unitetit të popullit është të mbikëqyrë funksionimin normal të mekanizmave kushtetues, duke ndërhyrë për eliminimin e mangësive në këtë drejtim³. Në këto kushte dhe në përmbushje të rolit dhe të misionit të tij, nga shqyrtimi i

² Në këtë Rezolutë, pika 49, në gjuhën angleze, citon se: “49. *Stresses that improved governance, transparency, legal certainty, inclusion and social dialogue are essential for stimulating foreign direct investment and the retention of skilled workers; calls for a meaningful inclusion of civil society and other relevant stakeholders in the debate over policy actions;*” Për më shumë: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2022-0214_EN.html

³ Vendimi nr. 26/2021, i Gjykatës Kushtetuese.

parashikimeve të këtij ligji, kuadrit ligjor në fuqi, në raport dhe me atë që deklarohet se synohet të arrihet, porse dhe mbajtja në vëmendje vetëm e interesit kombëtar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, veçanërisht asaj me vlera universale, Presidenti i Republikës ka vlerësuar se ky ligj duhet t'i kthehet Kuvendit për rishqyrtim, për një rivlerësim më të thelluar të nismës në raport me interesin më të lartë të vendit në ruajtjen dhe miradministrimin e pasurisë kulturore, për arsyet si më poshtë vijon.

I. Mbi rëndësinë e padiskutueshme dhe vlerat e paçmuara të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe detyrimin e shtetit shqiptar për ruajtjen e tij, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Konventës së Trashëgimisë Botërore të Parisit 1972

1. Siç citohet në Raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Butrinti u shpall Monument Kulture në vitin 1948. Në vitin 1981, zona e pyllëzuar përreth Butrintit u shpall gjithashtu Monument Kulture, sipas ligjeve ekzistuese për mbrojtjen e zonave arkeologjike me rëndësi mjedisore. Në vitin 1992 Komiteti i Trashëgimisë Botërore e përfshiu qytetin antik në listën e pasurive botërore të UNESCO-s.

1.1 Parku Kombëtar i Butrintit u krijua nga Ministria e Kulturës, duke përfshirë një sipërfaqe toke shtetërore prej 29 km². Kufijtë e këtij Parku, shtrihen në daljen e fshatrave përreth tij, si Ksamili, Vrina, Shëndëllia dhe Xarra. Krijimi i Parkut Kombëtar u bë një domosdoshmëri për ruajtjen e vendndodhjes dhe atmosferës unike të Butrintit, për ruajtjen e të dhënave arkeologjike të disa qendrave dhe monumenteve të zbuluara në këtë vatër të qytetërimit antik, si dhe për një menaxhim më efektiv, duke reflektuar edhe rekomandimet e UNESCO-s të vitit 1997.

1.2 Për administrimin e Parkut Kombëtar u krijua Zyra e Administrimit dhe Koordinimit, e cila është person juridik publik që mbështet, nxit, koordinon dhe mbikëqyr kërkimet shkencore, në bashkëpunim me institucione shtetërore ose private, kombëtare dhe ndërkombëtare për promovimin, ruajtjen, pasurimin dhe ekspozimin e trashëgimisë kulturore, për menaxhimin dhe ruajtjen e mjedisit në Parkun Kombëtar të Butrintit.

1.3 Brenda Parkut ndodhen 10 zona të shquara arkeologjike që lidhen me historinë e Butrintit. Disa prej tyre janë zona brenda mureve të Butrintit, ajo jashtë mureve, Diapori, Fortesa - Kalaja e Ali Pashë Tepelenës, Kalivoi, Shën Dëllia, Shën Dhimitri, Xarra, Ana e Kanalit të Vivarit etj. Specialistë të arkeologjisë kanë theksuar se "Butrinti është një thesar i jashtëzakonshëm për Shqipërinë" dhe se "çelësi është zhvillimi i ekuilibruar dhe turizmi i padëmshëm".

2. Mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe zhvillimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, përpos praktikës parlamentare, Presidenti i Republikës, ka administruar dhe është njohur edhe me qëndrime apo vlerësime të ekspertëve, që nuk kanë qenë pjesë e procesit të diskutimit gjatë shqyrtimit të ligjit nr. 50/2022, për të cilat Presidenti çmon se duhet të jenë pjesë e këtij arsyesimi dhe Kuvendi nuk duhet t'i anashkalojë, por do të duhet t'i shqyrtojë ato me shumë vëmendje.

2.1 Konkretisht, dy organizime të shoqërisë civile, përkatësisht Akademia “Rrënjët Tona” dhe “Aleanca për Mbrojtjen e Butrintit”, përpos reagimeve publike në median e shkruar, vizive dhe elektronike, në datën 14 qershor 2022, i kanë parashtruar Presidentit një material të shkruar studimor, përmbajtja e të cilit gjendet i plotë në **Shtojcën nr. 1**, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij arsyetimi, si dhe kopje e praktikës së administruar zyrtarisht në Institucionin e Presidentit të Republikës me nr. 2129 prot..

2.2 Në këtë material studimor⁴, citohet ndër të tjera se:

“Butrinti quhej nga Virgjili, Troja në miniaturë - Kështjella - Sipas shkrimtarit të lashtë, Stefan Bizantin, ishte themeluar nga Heleni, vëllai i heroit të famshëm trojan, Hektorit: “...tregojnë legjendën se emrin ia vuri Heleni, kur duke lundruar nga Troja për në Perëndim, bëri fli gjatë zbritjes së tij në Epir. Ardhjen e trojanëve në Buthrot e tregon edhe një kodër e quajtur Troja, të cilën ata e përdorën për të ngritur lëmin. Në këtë poemë, ai tregon rrugën e gjatë që bën Eneu që nga Troja, të cilën e braktis mes flakëve, duke mbajtur mbi supë babain e tij plak, Ankizin, dhe duke tërhequr prej dore të birin, Julin. Pra, Kaoni djali i Priamit, kishte ardhur para Eneas në Butrint, të cilën e quajti atë Troja e vogël. Veprimtaria në Butrint ra dukshëm me vërshimin e fiseve Gote, aty nga shekulli i VIII pas krishtit. Një heshtje thuhet e plotë bie mbi të gjatë 10 shekujve. Në shekullin 16-17 ishte për pak kohë nën zotërimin e Venedikut dhe me ardhjen e turqve, Butrinti, jo pa qëllim, thuhet braktiset. Sepse mbajtja gjallë e tij mund të bënte që shqiptarët t’ë kujtoheshin se kush ishin dhe nga vinin. Gjithsesi, ai ngelet qytet trojan, qytet që priti e përcolli me mijëra trojanë, duke i gatitur ata për civilizime dhe mbretëri të reja. Ju kujtojmë themeluesit e Romës, Jul Cesarin, Aleksandrin e Madh, Pirron e Epirit, që të gjithë mbaheshin si stërnipër të Akilit apo pellazgëve hyjnorë. Në librin III të Eneidës, në vargjet 502 etj., Enea, në çastin kur niset nga brigjet e Epirit, për të dalë në Otranto, bën këtë lutje: “Dua që këto qytete aleate e këta popuj kushërinj, të Epirit dhe Hesperia-s, që kanë të njëjtin themelues, Dardanin, të kenë në zemër vetëm një Trojë”.

Butrinti, është cilësuar si një **qytet i fisit Epirot të Kaonëve i banuar që në kohërat parahistorike, fakt historik i njohur.**

2.3 Madje, në këtë material hidhen edhe dyshime serioze në dëm të interesit kombëtar shqiptar:

“Hapja e Shqipërisë tërhoqi shumë institucione të huaja të interesuara për të gërmuar në Butrint, por jemi skeptik nëse kanë një synim të sinqertë për të zbuluar të vërtetën,

⁴ Ky material është hartuar dhe nënshkruar nga Prof. Dr. Apollon Bace, Prof. Ing. Av. Sazan Guri, Dr. Stefan Pinguli, Aulon Kalaja, Fred Balaj, Andi Tepelena, Dod Luli, Av. Redon Meksi, Av. Kristi Kurti, Av. Dorina Ruda, Av. Kujtim Cakrani.

apo për të vënë një vulë greko-romake në këtë vend të madh arkeologjik dhe kulturor shqiptar me rëndësi ndërkombëtare.”

2.4 Për vlerat që bart, Siti i Trashëgimisë Botërore të Butrintit, është përcaktuar nga Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulture e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), në listën e tij të vitit 1992, dhe të përditësuar në vitet 1999 dhe 2007.

Pra Parku Kombëtar i Butrintit është një pasuri kulturore e paluajtshme me vlera universale, e regjistruar në listën e Trashëgimisë Kulturore të UNESCO-s.

3. Mbrojtja dhe menaxhimi i pasurive të Trashëgimisë Botërore duhet të sigurojë që vlerat e tyre universale, duke përfshirë ruajtjen e kushteve të integritetit dhe autenticitetit në kohën e përfshirjes në UNESCO, dhe për këtë është detyrim i shtetit shqiptar të marrë të gjitha masat e nevojshme.

3.1 Një nga çështjet problematike të ligjit nr. 50/2022, objekt shqyrtimi është fakti se nga shqyrtimi i përmbajtjes së tij në krahasim **me detyrimet që përcakton Konventa e Trashëgimisë Botërore të Parisit 1972, rezulton se ligji bie ndesh me parashikimet e Konventës dhe në këtë mënyrë bie ndesh dhe me dispozitat e Kushtetutës.**

3.2 Konventa e Trashëgimisë Botërore e Parisit e vitit 1972, është një aktet që shteti shqiptar e ka ratifikuar në **datën 10.07.1989**, dhe ligji ratifikues ka hyrë në fuqi më 10.10.1989⁵.

3.3 Është Kushtetuta, që në nenin 5, përcakton detyrimin e Shqipërisë për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për të, ku përfshihet edhe kjo Konventë, ndërkohë që është po Kushtetuta ajo që në nenin 122 të saj, sanksionon se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.”

3.4 Ndërkohë që dhe neni 180, paragrafi 1, i Kushtetutës, sanksionon se:

⁵ Për më shumë, referojuni: <https://treaties.un.org/Pages/showDetails.aspx?objid=08000002800fece0&clang=en>

“Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute konsiderohen të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute.”

3.5 Ndaj dhe Konventa e Trashëgimisë Botërore të Parisit 1972, është një ndër aktet, që sipas nenit 116, 122, 180 të Kushtetutës, është në fuqi dhe qëndron mbi ligjet në hierarkinë e akteve, menjëherë pas ligjit themeltar të shtetit dhe që ka epërsi mbi çdo normë që nuk bie në pajtim me të, që në rastin konkret është ligji objekt shqyrtimi nr. 50/2022 i miratuar nga Kuvendi.

3.6 Është po Kushtetuta, që vlerat universale që parashikojnë aktet ndërkombëtare, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, i ka përthithur dhe trupëzuar në vetë tekstin e saj, ku në rastin konkret sa i takon mbrojtjes, ruajtjes, dhe zhvillimit të vlerave universale botërore dhe parimeve më të larta shoqërore që lidhen me identitetin kombëtar i ka parashikuar që në Preambulën dhe në nenin 3, të saj.

3.7 Ndaj, përpara miratimit të çdo norme të re ligjore që tenton të rregullojë çështje të asaj natyre që Kushtetuta apo Konventat Ndërkombëtare i parashikojnë të rëndësishme, themelore, universale për vetë jetën, shoqërinë, civilizimin dhe mbarë njerëzimin, dhe i trajtojnë këto çështje drejtpërdrejtë në dispozitat e tyre, ligjvënësi duhet të tregojë një kujdes të veçantë në mënyrë që këto akte të reja ligjore, përmes të cilave synohet të rregullohen çështje të lidhura me to, të mos anashkalojnë e aq më pak të bien ndesh me aktet themeltare mbi të cilat ngrihet dhe ka pranuar të funksionojë një shtet.

3.8 Në nenin 4, të saj kjo Konventë parashikon shprehimisht se:

“Cilido Shtet Palë në këtë Konventë pranon se detyra e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transmetimit tek brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore e referuar në Nenet 1 dhe 2 e që ndodhet në territorin e tij, i përket kryesisht atij shteti. Ai do të bëjë gjithçka që mundet në këtë përfundim, deri në fund të burimeve të tij dhe, atje ku është e përshtatshme, me ndonjë ndihmë dhe bashkëpunim ndërkombëtar, në veçanti, financiare, artistike, shkencore dhe teknike, të cilat mund të jetë në gjendje për t’i përfituar.”⁶

3.9 Ndërkohë që neni 17, i kësaj Konvente përcakton se:

“Shtetet Palë në këtë Konventë do të marrin në konsideratë ose inkurajojnë themelimin e fondacioneve kombëtare publike dhe private ose organizatave qëllimi i të cilave

⁶ Përmbajtja e nenit 4, të Konventës, në gjuhën angleze: “Each State Party to this Convention recognizes that the duty of ensuring the identification, protection, conservation, presentation and transmission to future generations of the cultural and natural heritage referred to in Articles 1 and 2 and situated on its territory, belongs primarily to that State. It will do all it can to this end, to the utmost of its own resources and, where appropriate, with any international assistance and co-operation, in particular, financial, artistic, scientific and technical, which it may be able to obtain.”

është të ftojë donacione për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore siç përcaktohet në Nenet 1 dhe 2 të kësaj Konvente.”⁷.

3.10 Pra sipas parashikimeve të vet Konventës, e gjithë përgjegjësia e administrimit të pasurive që përbëjnë trashëgimi kulturore nuk mund të kalojë kurrësi në një organizëm shoqëror siç janë OJF-të, por ajo ngelet përgjegjësi e shtetit palë që ka nënshkruar Konventën. Ndërkohë që, në asnjë rast nuk parashikohet që këto fondacione të kenë të drejta administrimi me të gjitha tagrat të një pasurie të paluajtshme me vlerë të tillë si Parku Kombëtar i Butrintit, siç synohet *de jure* dhe *de facto* t'i jepet një fondacioni, përmes marrëveshjes së propozuar për miratim me ligjin nr. 50/2022.

3.11 Si rezultat i zbatimit automatik të Konventës, pavarësisht se Kuvendi ka zgjedhur të miratojë me ligjin nr. 27/2018, format e administrimit të pasurive kulturore dhe më tej propozon e miraton edhe një ligj të posaçëm për miratimin e një marrëveshjeje (siç propozohet me ligjin nr. 50/2022), **kjo nuk e zhbën fuqinë detyruese të Konventës për shtetin shqiptar, për të mos hequr dorë nga përgjegjësia dhe administrimi me tagra të plota i pasurisë së Parkut Kombëtar të Butrintit.**

3.12 Argumenti i përdorur edhe në hyrje të marrëveshjes, edhe në relacionin shpjegues apo raportet e komisioneve parlamentare që kanë shqyrtuar nismën, se kjo marrëveshje nënshkruhet mbështetur në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (neni 171- 172), nuk qëndron në raport me detyrimin që ka po vetë shteti sipas dispozitave të sipërcituara të Konventës dhe në respektim të neneve 3, 4, 5 dhe 116, 122, 180, të Kushtetutës.

3.13 Nëse një apo disa dispozita të një ligji krijojnë hapësirë të interpretueshme në rastet e aplikimit në praktikë, siç mund të jetë rasti kur formëzohen forma bashkëpunimi që cenojnë norma të Konventës, por që kjo dispozitë nuk është konstatuar apo kundërshtuar sipas nenit 131, pika 1, germa “a” dhe “c”, dhe brenda afateve të parashikuara nga neni 50, i ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, sërish shtetit palë edhe pse mund të ketë krijuar një normë të tillë të interpretueshme në kuadrin e brendshëm ligjor, i mbetet i pandryshuar detyrimi për respektimin e normave dhe detyrave që rrjedhin drejtpërdrejtë nga Kushtetuta dhe Konventa, të cilat kanë epërsi mbi të drejtën e brendshme.

Pra në momentin fundor të hartimit dhe nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, moment ky kur janë zbatuar efektisht nenet 171 dhe 172 të ligjit nr. 27/2018, patjetër që është domosdoshmëri krahasimi i normave konkrete të dy akteve që gjejnë zbatim (dispozitat e neneve 171-172 të ligjit nr. 27/2018 me dispozitën e nenit 17 të Konventës), për të qartësuar se cila është përputhshmëria e kësaj iniciative të brendshme me normat e Konventës.

⁷ Përmbajtja e nenit 17, të Konventës, në gjuhën angleze: “The States Parties to this Convention shall consider or encourage the establishment of national public and private foundations or associations whose purpose is to invite donations for the protection of the cultural and natural heritage as defined in Articles 1 and 2 of this Convention.”

3.14 Sipas pikës 5, të nenit 172, të ligjit nr. 27/2018, një formë e tillë bashkëpunimi përmes fondacioneve në praktikë do të realizohet vetëm pas nënshkrimit të një marrëveshjeje midis shtetit dhe një fondacioni të posaçëm të krijuar me pjesëmarrjen e po vet shtetit.

Konkretisht, në pikën 5, të nenit 171, të ligjit nr. 27/2018, parashikohet se:

“5. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore për administrimin, sipas këtij neni. Kjo marrëveshje i nënshtrohet miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi kombëtare dhe lokale, dhe miratimit të saj në Kuvend, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, sipas parashikimeve të këtij ligji. Marrëveshja përcakton, ndër të tjera, afatin, tarifën dhe kushtet e veçanta për administrimin e pasurisë kulturore. Në kryerjen e funksioneve të mbrojtjes, ruajtjes, restaurimit, vlerësimit e administrimit të pasurisë, subjektet zbatojnë parimet dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe nuk u nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.”

Pra është shumë e qartë, që Kuvendi i Shqipërisë, në momentin e hartimit dhe miratimit të nenit 171 të ligjit nr. 27/2018, për pasuritë e paluajtshme me vlera kulturore universale, ka përcaktuar veten si një filtër përfundimtar të kontrollit të çdo detaji që do të përmbajë kontrata e bashkëpunimit.

Në rastin konkret, situata e antikushtetutshmërisë dhe rënia ndesh me Konventën dhe për pasojë me Kushtetutën, *shfaqet në momentin kur vihet në zbatim norma* (neni 171-172 i ligjit nr.27/2018⁸), e që në rastin konkret kërkon hartimin dhe nënshkrimin e një kontrate dhe konkretizimin e një forme bashkëpunimi, të përcaktuar në detaje, **që duhet të miratohet sërish përmes një ligji**, por dhe të jetë në harmoni me parashikimet e Konventës, qoftë sa i takon përgjegjësisë themelore dhe të pandryshueshme të shtetit për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kushtetuta dhe Konventa, qoftë përsa i takon pjesëmarrjes dhe rolit të shtetit në fondacionin e posaçëm, përmes mekanizmave apo mjeteve që nuk lëkundin asnjëherë pozitën e tij kryesore si pronar dhe administrues i pasurisë.

Këto detyrime dhe këto garanci marrëveshja e miratuar me ligjin nr. 50/2022, objekt shqyrtimi, nuk i ofron duke rënë ndesh me parashikimet e nenit 7 dhe 17 të Konventës.

3.15 Nëse Konventa pranon ekzistencën dhe ndihmesën e fondacioneve të posaçme, publike apo private, qëllimi i vetëm i lejueshëm i veprimtarisë së tyre, është kryerja e veprimtarisë filantropike të mbledhjes së sa më shumë fondeve në funksion të përdorimit të tyre për mbrojtjen dhe

⁸ Ku parashikohet se, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, nga formacione hibride (shtet-privat) është e domosdoshme që marrëveshja të miratohet nga Kuvendi, pra sërish me nxjerrjen e një tjetër ligji, që në rastin konkret është ligji nr. 50/2022, objekt shqyrtimi.

zhvillimin e pasurisë kulturore botërore, **dhe në asnjë rast ky parashikim i Konventës nuk ka parasysh që të zhveshë shtetin palë nga autoriteti dhe përgjegjësia e tij për t'i ruajtur dhe zhvilluar ato.**

3.16 Edhe sikur të merret në analizë pretendimi i Qeverisë dhe Kuvendit se, shteti përfaqësohet në fondacionin e krijuar enkas për administrimin e Parkut të Butrintit, minimalisht do të duhej që përmes parashikimeve në marrëveshje, apo pjesëmarrjes solide dhe diktuese në fondacionin e posaçëm të krijuar, ai (pra shteti) **do të duhet të ruante të palëkundur pozitën e tij dominuese në organet vendimmarrëse, në mënyrë të pakushtëzuar dhe për çështje me rëndësi, të zotëronte dhe të drejtën e vetos në funksion të ruajtjes së interesit publik dhe përmbushjes së detyrimeve të Konventës dhe respektimit të Kushtetutës.**

4. Në vijim të këtij arsyetimi, Presidenti i Republikës nuk anatemon për asnjë shkak historikun dhe as veprimtarinë tepër të vyer të partnerit të përzgjedhur nga shteti - Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, sepse në historinë 30 vjeçare të funksionimit të tij, bashkëpunimit, ndihmës, dhe mbështetjes që ky organizëm ka ofruar, ka lënë gjurmë dhe shembuj tepër pozitivë për shtetin shqiptar.

4.1 Por kur bëhet fjalë për këtë lloj mënyre bashkëpunimi, dhe për një pasuri të kësaj natyre, shteti shqiptar nuk mundet që *a priori* të zhveshë veten nga përgjegjësitë e tij, që i takojnë me Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare të ratifikuara.

4.2 Ndaj në këtë drejtim, marrëveshja e lidhur dhe forma e zgjedhur e bashkëpunimit për administrimin e një pasurie me vlera kulturore universale, duhet të bëhet në përputhje me përgjegjësitë shtetërore që ia ngarkojnë aktet ndërkombëtare, ligji themeltar i shtetit dhe me vizionin e së ardhmes pa kufij kohorë për brezat që do të vijnë, e jo të fragmentarizuar në plane 10 vjeçare.

Ndaj sa më sipër, si President i Republikës, çmoj se kjo çështje duhet të marrë kohën e nevojshme dhe të shqyrtohet me kujdesin maksimal nga Kuvendi i Shqipërisë, duke tërhequr dhe realizuar konsultim gjithëpërfshirës dhe diskutim me të gjithë, në mënyrë që çdo vendimmarrje mbi këtë çështje të tërheqë konsensus sa më të gjerë dhe pranim të zgjidhjes pa kundërshtime.

II. Mbi mënyrën e zgjedhur për administrimin e trashëgimisë kulturore dhe procedurën e ndjekur

1. Marrëveshja e lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit “Për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit”, ka filluar si iniciativë, është propozuar dhe miratuar përmes ligjit

nr. 50/2022, duke u mbështetur tek nenit 172, pika 5, të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Neni 172, i ligjit nr. 27/2018, përcakton se:

“Neni 172

Fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore

- 1. Administrimi i pasurive të trashëgimisë kulturore mund të kryhet edhe nga persona juridikë jofitimprurës, të bashkëthemeluar ndërmjet institucioneve shtetërore, të përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, dhe personave fizikë ose juridikë privatë, vendas apo të huaj, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin civil në fuqi. Administrimi, sipas këtij neni, ka për qëllim mbrojtjen, ruajtjen, restaurimin, vlerësimin e pasurive kulturore dhe dhënien në përdorim të drejtpërdrejtë, në mënyrë joshteruese, qoftë veç e veç.*
- 2. Personi juridik krijohet në formën e fondacionit. Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së tij është administrimi i pasurive kulturore, në kuptim të pikës 1 të këtij neni.*
- 3. Organizimi dhe funksionimi i fondacioneve të krijuara sipas pikave 1 e 2, të këtij neni, u nënshtrohet rregullave të legjislacionit civil në fuqi për organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe parashikimeve të këtij ligji, për aq sa janë të zbatueshme, duke ruajtur pavarësinë e funksionimit dhe të respektimit të tyre nga ana e shtetit.*
- 4. Rregullat bazë të organizimit dhe funksionimit të fondacioneve të posaçme të trashëgimisë kulturore vendosen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në marrëveshjen e posaçme që lidhet ndërmjet palëve.*
- 5. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore për administrimin, sipas këtij neni. Kjo marrëveshje i nënshtrohet miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi kombëtare dhe lokale, dhe miratimit të saj në Kuvend, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, sipas parashikimeve të këtij ligji. Marrëveshja përcakton, ndër të tjera, afatin, tarifat dhe kushtet e veçanta për administrimin e pasurisë kulturore. Në kryerjen e funksioneve të mbrojtjes, ruajtjes, restaurimit, vlerësimit e administrimit të pasurisë, subjektet zbatojnë parimet dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe nuk u nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.*
- 6. Personat juridikë, të krijuar për këtë qëllim, e realizojnë veprimtarinë e tyre me fonde të themeluesve të tyre dhe çdo burimi tjetër financimi, në bazë të legjislacionit në fuqi.*
- 7. Veprimtaria ekonomike e personave juridikë, fondacioneve që themelohen dhe operojnë për këtë qëllim, sipas këtij neni, nuk i nënshtrohet ligjit për tatimin mbi fitimin në Republikën e Shqipërisë dhe përjashtohet nga pagesa e TVSH-së. Gjithashtu, furnizimet e kryera në funksion të objektit të veprimtarisë së këtyre subjekteve përjashtohen nga detyrimet e importit dhe detyrimet e tjera doganore.*

8. Të ardhurat e krijuara nga veprimtaria ekonomike e fondacioneve të veçanta administrohen prej tyre, sipas parashikimeve të marrëveshjes së përmendur në pikën 5 të këtij neni.

9. Pasuria, që përbën vlerë të trashëgimisë kulturore, i kalon në administrim, në kuptim të këtij ligji, fondacionit të krijuar për këtë qëllim, sipas marrëveshjes ndërmjet këtij të fundit me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Në çdo rast, titulli i pronësisë i mbetet shtetit.”

2. Ndërsa sipas relacionit shpjegues të projektligjit:

“Modeli i administrimit të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të parkut kombëtar të Butrintit, i parashikuar nga marrëveshja e administrimit nëpërmjet administrimit tërthorazi përmes krijimit të një fondacioni të dedikuar, erdhi si një nevojë për gjetjen e mënyrave të reja të administrimit, pasi sistemi aktual i menaxhimit, edhe pse ka siguruar i sforcuar mbrojtjen e vlerave kulturore të parkut kombëtar të Butrintit, nuk ishte fleksibël, duke mos garantuar në perspektivë mbrojtjen e ruajtjen e vlerave kulturore dhe natyrore të sitit dhe zhvillimin e integruar të tij, si dhe duke siguruar të ardhura jo me pritshmëritë që duhet të ketë një pasuri me vlera kaq të rëndësishme kombëtare e universale.”

Po sipas relacionit, kjo mënyrë administrimi nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, sikurse është parashikuar në marrëveshjen e administrimit, do të sigurojë:

- menaxhim të integruar të pasurisë kulturore dhe natyrore të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të parkut kombëtar të Butrintit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të një qendre, njëherësh pasuri botërore e UNESCO-s dhe sit RAMSAR;
- lehtësira, fleksibilitet dhe avantazhe në mbledhjen e fondeve, shfrytëzimin e financimeve nga burime të ndryshme, rritjen e të ardhurave nëpërmjet aktivitetit tregtar, sponsorizimit, angazhimeve të palëve të treta;
- ekspertizë të kualifikuar menaxhimi, kërkimi, konservimi, marketingu, etj., në përputhje me standardet dhe nevojat bashkëkohore
- strukturë menaxhimi në sit më të madhe në numër dhe të kualifikuar për fushat e nevojshme të ekspertizës dhe menaxhimit;
- zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë Parkun Kombëtar të Butrintit dhe avantazhe ekonomike për komunitetin lokal nëpërmjet rritjes së fondeve, investimeve në përmirësimin e infrastrukturës turistike, zhvillimin e kapaciteteve lokale dhe rritjes së punësimit në Park.

Ndërkohë që në pjesën XI të relacionit, thuhet se:

“Vlera e financimit nëpërmjet grantit të AADF do të jetë deri në vlerën katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë dollarë (4,985,000 \$) ndërsa vlera e saktë e fondeve

të papërdorura dhe të mbartura të administruara/kontabilizuara nga ZAKPA Butrint do të përcaktohet në datën e transferimit.”

Po të njëjtat deklarime janë bërë nga ministrja e Kulturës edhe përgjatë seancave dëgjimore në Kuvendin e Shqipërisë, përgjatë shqyrtimit të kësaj nisme, si në komisionet parlamentare për dhënie mendimi, ashtu dhe në Komisionin përgjegjës, ku ministrja ndër të tjera ka theksuar se⁹:

“[...] modeli i administrimit të nënzonës së trashëgimise dhe peizazhit kulturor të parkut kombëtar të Butrintit, i parashikuar nga marrëveshja e administrimit nëpërmjet administrimit tërthorazi përmes krijimit të një fondacioni të dedikuar, erdhi si një nevojë për gjetjen e mënyrave të reja të administrimit, pasi sistemi aktual i menaxhimit, edhe pse ka siguruar i sforcuar mbrojtjen e vlerave kulturore të parkut kombëtar të Butrintit, nuk ishte fleksibel, duke mos garantuar në perspektivë mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore dhe natyrore të sitit dhe zhvillimin e integruar të tij, si dhe duke siguruar të ardhura jo të përputhshme me pritshmëritë që duhet të ketë një pasuri me vlera kaq të rëndësishme kombëtare e universale.”

Deklarime thuajse të njëjta me atë të sipërcituar janë bërë në të gjitha komisionet parlamentare.

2.1 Pra me një pranim të tillë të qeverisë, bërë përmes ministrit të Kulturës, duket sikur arsyeja e kësaj forme dhe mënyre bashkëpunimi bëhet pasi shteti, përmes strukturave të tij, edhe pse ka njëkohësisht si autoritetin rregullator, ashtu dhe forcën shtrënguese, deklaron paaftësinë e tij, pamundësinë, apo dhe padijeninë në përmbushjen e detyrimeve ndaj shtetasve të tij, dhe të detyrimeve ndërkombëtare që ka marrë përsipër përmes ratifikimit të konventave.

Kjo mënyrë deklarimi që nuk përkon aspak me realitetin, është e papranueshme për Republikën e Shqipërisë, sepse shteti shqiptar ka kapacitetet, mundësitë, dhe burimet njerëzore e financiare për të garantuar ruajtjen, mbrojtjen e vlerave kulturore të Parkut Kombëtar të Butrintit, një pasuri me vlera kaq të rëndësishme kombëtare e universale.

Nëse sistemi i menaxhimit duhet përmirësuar, dhe për këtë nevojitet njohuri dhe mbështetje, kjo është e mirëpranuar nga të gjithë, por në asnjë mënyrë autoriteti rregullator dhe kapaciteti buxhetor i një shteti, nuk mund të deklarohen se nuk garantojnë dot ushtrimin e pushtetit dhe përmbushjen e detyrimeve të tij.

Presidenti i Republikës nuk është kundër formave të bashkëpunimit shtet - privat, apo përmes strukturave të shoqërisë siç janë fondacionet, aq më pak kur bëhet fjalë për Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), i cili ka një historik mbi 25 vjeçar bashkëpunimi dhe ka realizuar

⁹ Shiko raportin e Komisionit të Politikës së Jashtme, Raport i datës 10 maj 2022.

me shtetin shqiptar projekte për forcimin e kapaciteteve, edukim dhe lidhshmëri, arsimim, përmirësime në infrastrukturë në qendra urbane, apo site historike kulturore.

Është vendi të kujtojmë se AADF dhe AAEF, kanë një historik bashkëpunimi me shtetin shqiptar dhe qeveritë e tij në këto 3 dekada, dhe ky bashkëpunim është ofruar dhe është realizuar pa asnjë dallim politik të shumicave qeverisëse të kohës. Mund të përmenden shumë investime, projekte dhe programe në këtë drejtim, të mbështetura dhe të realizuar në partneritet prej AADF me shtetin shqiptar, si në nivel qendror, ashtu dhe në atë vendor¹⁰.

Por nga ana tjetër, është e papranueshme logjika që për një pasuri të kësaj natyre si **Butrinti**, në zonën ku ndodhet, dhe me vlera kaq të larta e me rëndësi për historikun, origjinën dhe trashëgiminë kulturore ndër breza, shteti të heqë dorë nga çdo përgjegjësi dhe autorizon një fondacion të dedikuar, **ku vet shteti është futur në strukturat vendimmarrëse të tij, por në një formë dhe në pozita që nuk garantojnë rolin diktues apo kontrollues sipas përgjegjësisë kushtetuese dhe publike që i takon.**

Nëse qeveria shqiptare deklaron **mos garantimin në perspektivë të mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave kulturore dhe natyrore të sitit dhe zhvillimin e integruar të tij, për një pasuri me vlera kaq të rëndësishme kombëtare e universale, ndërkohë që aktualisht ka përgjegjësinë dhe administrimin shtetëror, si do të mundet ta garantojë atë me pjesëmarrje në një fondacion (OJF), ku rolin dhe fuqinë vendimmarrëse e ka të kufizuar?!**

Këto deklarime janë të pambështetura në argumente, se përse krijimi i një fondacioni të posaçëm, që do të funksionojë në respektim dhe të legjisllacionit mbi organizatat jo fitimprurëse, ku shteti ka pakicën vendimmarrëse, është më i aftë dhe me fuqi më të lartë se vet shteti dhe se sistemi aktual i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, për të garantuar mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore e natyrore, si dhe zhvillimin e integruar të tij në perspektivë.

Shteti, nuk mundet që në këtë mënyrë, formë dhe përmbajtje të deklarojë kaq hapur pamundësinë për të përmbushur funksionet themelore të tij.

Nëse qeveria në përmbushje të programit politik, dhe për të përmbushur një qëllim legjitim për të realizuar më mirë dhe në funksion të interesit dhe të mirës publike një politikë të

¹⁰ Për më shumë vitizo linkun e AADF : <https://aadf.org/> , ku gjenden të publikuara projektet, programet dhe aktivitetet e realizuara, të tilla si: TIDVlorë; TID Gjirokastër; TID Tirana (Pazari i Ri/Sheshi Avni Rustemi); TID/BID Pazari Vjetër Korçë; TID Kruja- Pazari Krujë; BID Berat; BID Korça; BID Shkora, si dhe LEAD Albania; Zhvillim i TIK në Arsimin Para-Universitar; Rritja e Ndërveprimit Dixhital në Shqipëri; Junior Achievement Kurrikula Baze ne Shkollat e Mesme; Software Development Academy Albania by Protik; Trashëgimi Kulturor Jomateriale; TUMO Tirana; CleanScore; TOEFL JUNIOR; TECH Crew; Bursa universitare në AUBG; Programi i praktikave profesionale në TIK, etj.

caktuar, qoftë dhe në aspektin e ruajtjes dhe zhvillimit të pasurisë kulturore me vlera universale, duhet të bëjë çdo përpjekje për ta siguruar atë, por përmes një procesi transparent, publik, të ndershëm, dhe për të garantuar nga njëra anë interesin publik, dhe nga ana tjetër respektimin e kuadrit ligjor të brendshëm dhe ndërkombëtar në fuqi.

Në këtë rast, Kuvendi i Shqipërisë, përmes diskutimeve në komisionet respektive parlamentare dhe deputetët e tij, duhet t'i parashtronin ministrit të Kulturës disa pyetje:

- A ka sot Republika e Shqipërisë institucione funksionale që kanë për detyrë e përgjegjësi pikërisht të realizojnë atë që mendojnë sot se mund të realizohet më mirë nga një fondacion?
- A i kanë humbur Shqipërisë ekspertët dhe personat që duan të punojnë për vendin e tyre?
- Cila është pengesa për Ministrinë e Kulturës? Mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe/apo mungesa e një mbështetjeje me 5 milion dollarë?!
- Po nëse modeli i menaxhimit të Butrintit sipas projektit të propozuar dhe studimit të realizuar me mbështetjen e partnerëve, realizohet nga vet shteti, përse nuk vlerësohet se mund të ketë sukses?
- Po nëse modeli i menaxhimit të Butrintit sipas projektit të propozuar dhe studimit të realizuar me mbështetjen e AADF-së, mund të realizohet më mirë nëse shteti, merr pjesë në fondacionin e posaçëm të krijuar, por përmes mekanizmave dhe një pakete që të garantojë fuqinë e tij vendimmarrëse diktuese, a përmbushet më mirë interesi publik?
- Çfarë njohurish dhe çfarë burimesh njerëzore dhe fleksibilitet ofron sot ky bashkëpunim më shumë se sa shteti shqiptar ka patur dhe ka në dispozicion?

Këto pyetje e shumë të tjera, duhet të ishin konsumuar me ministrin propozues përgjegjës për çështjet e kulturës, por përmes një procesi ballafaqimi dhe të aktorëve dhe ekspertëve të tjerë që e njohin çështjen, që e njohin Butrintit dhe kanë dhënë kontribut shkencor dhe profesional ndër vite lidhur me ruajtjen, administrimin dhe zhvillimin e tij.

Në çështje kaq të rëndësishme, është themelore që organi vendimmarrës, në këtë rast Kuvendi, ta realizonte këtë proces duke vënë në shfrytëzim parimin e kontradiktorialitetit dhe jo të kundërshtimit të çdo nisme; të siguronte oponentin më të mirë, dhe sigurisht përmes një vullneti të sigurtë zgjidhja që do të ofronte, patjetër do të ishte më e plotë.

2.2 Nga ana tjetër, konstatohet një tjetër çështje që duhet të kishte marrë trajtim nga Kuvendi, lidhur me përzgjedhjen e subjektit bashkëpunues dhe krijimit të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit. Sipas relacionit, përzgjedhja e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim është bërë në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr. 583, datë 14.10.2019, të ministrit të Kulturës, "*Për miratimin e kritereve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim*", dhe është vendosur me **vendimin nr. 3, datë 6.4.2020**, të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore.

2.2.1 Me aktin e themelimit të datës **11.06.2021**, mes Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit Shqiptaro- Amerikan për Zhvillim, është themeluar para noterit “Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit”.

2.2.2 Ndërsa vetë Fondacioni është regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin **nr. 858, datë 21.7.2021**, sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse.

2.2.3 Në datën **16.11.2021**, ende pa ndjekur procedurat e miratimit të *marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit*, rezulton të jetë nënshkruar një Protokoll Bashkëpunimi mes:

- Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit;
- Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë; dhe
- Institutit të Arkeologjisë.

2.2.4 Ecuria dhe shtrirja kohore e gjithë këtyre veprimeve, edhe duke lexuar Relacionin shpjegues të nismës, apo duke iu referuar diskutimeve në komisionet parlamentare, nuk hedh dritë mbi shumë procese që kanë çuar në konkretizimin e këtij projektligji me një marrëveshje konkrete që iu servir Kuvendit për miratim. Konkretisht, nuk jepen sqarime shteruese, por gjithçka relatohet në mënyrë të përgjithshme, mbi:

- i.** Mënyrën se si është vlerësuar nevoja për ndryshimin e formës së administrimit të Parkut Kombëtar të Butrintit;
- ii.** Analizën që është bërë mbi menaxhimin aktual të Parkut Kombëtar të Butrintit;
- iii.** Evidentimin e mënyrës se si duhet të administrohet në vijim Parku Kombëtar i Butrintit dhe konsultimeve të bëra për këtë qëllim me ekspertë të pavarur të trashëgimisë kulturore dhe jo vetëm;
- iv.** Momentit kur është vendosur nisja e procedurës përzgjedhëse të një fondacioni sipas Udhëzimit nr. 583, datë 14.10.2019, të ministrit të Kulturës “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim” dhe konsultimet e bëra për këtë qëllim me ekspertë të pavarur të trashëgimisë kulturore;
- v.** Si është vendosur përzgjedhja e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, me vendimin nr. 3, datë **6.4.2020**, të Këshillit të Menaxhimit të Pasurive Kulturore, pa patur ekspertizën e duhur për vlerësimin e kriterëve përzgjedhëse?
- vi.** A ka patur subjekte të tjera që kanë shprehur interes për krijimin e një fondacioni të posaçëm për administrimin indirekt të Pasurisë Kulturore?
- vii.** Kur është negociuar drafti i marrëveshjes në mbrojtje të interesit më të lartë të trashëgimisë kulturore kombëtar dhe nga cilët personat përfaqësues të grupit negociator?
- viii.** A ka patur procese të faktuara konsultimi, transparente, para, gjatë negociimit të marrëveshjes dhe para lidhjes së saj, veçanërisht sa i përket modelit të përzgjedhur të administrimit?

- ix. Duke qenë se partneri i përzgjedhur ka mbështetur dhe *Planin e Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar Butrint 2020-2030*, hartuar si bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si bashkë propozues, apo institucione të tjera në varësi të ekzekutivit si AKZM, Instituti i Arkeologjisë, ADZM Vlorë, Porti i Sarandës; **përpos këtyre, cilët janë aktorët e tjerë të interesit dhe grupet e shoqërisë civile, apo ekspertë vendas, apo përfaqësues të komunitetit lokal me të cilët është konsultuar ky plan menaxhimi? A janë reflektuar qëndrimet objektive të këtyre të fundit në produktin final të miratuar më pas nga qeveria shqiptare? Po me Akademinë e Shkencave, akademikë, Akademinë e Studimeve Albanologjike, apo me studimet dhe dokumentet e prodhuar prej këtyre autoriteteve, a ka patur konsultime? Nëse po, a janë krahasuar studimet apo vet plani i hartuar nga ekspertët e huaj dhe a janë reflektuar përpara miratimit komentet?**
- x. A është vlerësuar paraprakisht nga ana e ministrisë/ve përgjegjëse niveli i riskut për këtë formë administrimit të kësaj pasurie kombëtare?
- xi. Shprehja e interesit nga partneri strategjik për marrjen në administrim të Parkut Kombëtar të Butrintit, ka përfshirë të gjitha nënzonat dhe sipërfaqen e miratuar si Park Kombëtar i mbrojtur? Nëse jo, cili do të jetë destinacioni i përdorimit, apo niveli i mbrojtjes së zonave pasuri pronë publike e paluajtshme, të lëna jashtë administrimit sipas kësaj marrëveshjeje?

3. Sipas praktikës parlamentare, me Vendimin nr. 3, datë **6.4.2020**, të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore, AADF është vlerësuar si partner strategjik për administrimin e pasurisë kulturore Parku Kombëtar i Butrintit.

3.1 Referuar Vendimit nr. 279, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave “*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore*” (përdorur si referencë ligjore edhe në Vendimin nr. 3, datë 6.4.2020, të sipërcituar), anëtarët e KKMPK-së, emërohen nga ministri me mandat 2 vjeçar, me kriter emërimi vetëm¹¹:

- zotëron diplomë të nivelit “Master profesional” apo “Master shkencor” dhe eksperiencë 5-vjeçare në fushat e **jurisprudencës, menaxhimit ose ekonomisë**;
- nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale.

Madje, dhe 5 personalitetet që janë anëtarë të këtij organi kolegjal, përveç atyre që janë përfaqësues të institucioneve publike, ***mjafton të kenë eksperiencë të pasur profesionale në fushën e jurisprudencës, ekonomisë ose menaxhimit***¹².

3.2 Ky organ, sipas nenit 40, të ligjit nr. 27/2018, ka kompetencë:

¹¹ Sipas pikës 6, të Vendimit nr. 279, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave “*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore*”.

¹² Sipas pikës 3, të Vendimit nr. 279, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave “*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore*”.

- a) të miratojë **strategjinë për administrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore;**
- b) të miratojë programin e zhvillimit në territor të trashëgimisë kulturore;
- c) të konsultojë ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore për tipologjinë e aktiviteteve tregtare që zhvillohen në ambientet e pasurive kulturore dhe në zonat e mbrojtura;
- ç) të miratojë kriteret për licencimin e subjekteve tregtare të dedikuara në fushën e promovimit e të prezantimit të vlerave kulturore, në ekspozita kombëtare e ndërkombëtare;
- d) të miratojë kriteret për akordimin e licencave për ekspert vlerësues të pasurive kulturore;
- dh) të hartojë, të miratojë e të propozojë te ministri marrëveshjet e partneritetit publik-privat në lidhje me pasuritë kulturore;
- e) të përcaktojë tarifat e përdorimit të pasurive kulturore, mënyrën e përdorimit dhe të destinacionit të tyre;
- ë) të përcaktojë kriteret dhe formatin e deklaratës së interesit kulturor ose shkencor të ekspozitave apo panairëve dhe të çdo iniciative tjetër me karakter kulturor, me qëllim zbatimin e lehtësive të parashikuara nga normativat fiskale;[...]

3.3 Sa më sipër, ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në asnjë rast nuk i ka dhënë kompetenca këtij organi, pra **Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore, që të “vlerësojë si partner strategjik” një subjekt që synon të marrë administrimin e një pasurie kulturore me vlera universale.**

Ky organ, sipas dispozitës së sipërcituar (nenit 40, pika 2, shkronja “a”), të ligjit nr. 27/2018 dhe të Kreut IV, të VKM-së nr. 279/2019, ka për kompetencë të miratojë vetëm strategjitë për administrim të qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore, por nuk ka as kompetencën ligjore dhe aq më pak ekspertizën e nevojshme për nga përbërja e tij me “juristë, menaxhues dhe ekonomistë”, të vlerësojë për një pasuri konkrete të trashëgimisë kulturore, subjektin që do e marrë në administrim, e aq më pak të vlerësojë të gjithë elementët që citohet se janë “vlerësuar” në vendimin nr. 3, datë 6.4.2020, si:

- eksperiencia në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar prej jo më pak se 5 vjet në fushën e trashëgimisë kulturore;
- nëse mund të sigurojë ekspertizën e nevojshme për kryerjen e funksioneve ruajtëse dhe mbrojtëse sipas natyrës së pasurisë kulturore referuar legjislacionit në fuqi në fushën e trashëgimisë kulturore; apo qoftë dhe
- kapacitetet teknike, për të marrë përsipër administrimin e pasurisë kulturore.

3.4 Në këto kushte, procesi i ndjekur për vlerësimin e AADF-së si partner strategjik për administrimin e pasurisë kulturore, **është kryer nga një organ që ligji nuk ia ka dhënë këtë**

tagër ligjor, duke bërë kështu të gjithë procesin absolutisht të pavlefshëm dhe çdo akt, duke filluar nga vetë vendimi nr. 3, datë 6.4.2020 e që ka pasuar vendimmarrjet e organeve të tjera mbështetur mbi të, të paligjshme, e për pasojë, në shkelje të parimit të ligjshmërisë sanksionuar në nenin 118, të Kushtetutës.

Duhet theksuar se, sipas akteve nënligjore të miratuara (VKM nr. 279/2019) Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore është organi më i rëndësishëm strategjik vendimmarrës që kryesohet nga Ministri i Kulturës që së bashku me Ministrinë e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj, duhet të realizojnë ato funksione që sot përmes ligjit nr. 50/2022, delegohen tek një Fondacion i posaçëm (Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit).

3.5 Vetë Kreu IV, i VKM-së nr. 279/2019, cenon nenin 118, të Kushtetutës, për sa kohë që kjo pjesë e VKM-së, ka renditur në kompetencat e Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore, **kompetenca që haptazi tejkalojnë parashikimet e nenit 40, të ligjit nr. 27/2018, duke i dhënë këtij organi (KKMPK-së), më shumë kompetenca nga ato që i ka njohur Kuvendi i Shqipërisë përmes ligjit.**

Pra edhe Këshilli i Ministrave, përmes VKM-së nr. 279/2019, ka kapërcyer kufijtë e ligjit, duke autorizuar një organ me më shumë kompetenca nga ato që Kuvendi i Shqipërisë përmes ligjit nr. 27/2018, i ka dhënë.

Rikujtojmë se, vetë Gjykata Kushtetuese është shprehur se, **parimi i shtetit të së drejtës** në jurisprudencën kushtetuese është trajtuar i lidhur ngushtë edhe me **parimin e hierarkisë së akteve normative**, duke e konsideruar këtë të fundit si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor.

Në këtë kuptim, duke qenë se parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, **aktet juridike që nxirren nga organet e pushtetit publik duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material (shih vendimet nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 25, datë 28.04.2014; nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese)**¹³.

Nga ana tjetër neni 118, pika 1, e Kushtetutës sanksionon se *“aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë”*. Ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni parashikon *“ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.”*

Këto dispozita ndihmojnë për t'i dhënë kuptimin kushtetues dhe doktrinar konceptit *“rezervë ligjore”*, nëpërmjet të cilit kufizohet apo orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të

¹³ Vendimi nr. 29/21 i Gjykatës Kushtetuese.

rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Kjo rezervë ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetutshmërisë (*shih vendimin nr. 60, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*)¹⁴.

3.6 Por ndërkohë Këshilli i Ministrave të njëjtin tejkalim, pra të mungesës së autorizimit të shprehur nga ligji nr. 27/2018, parashikuar në nenin 40 të tij, **e bën sërish tek një tjetër vendim që ka miratuar**. Konkretisht tek pika 1, seksioni A, Kreu IV, i vendimit nr. 625, datë 4.09.2019, i Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit*”, përcakton se:

*“Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore, **për vlerësimin e partnerit strategjik**, mbështetet në plotësimin e të gjitha kriterëve, si vijon: [...]”*

Në këtë mënyrë, Këshilli i Ministrave ka konsumuar kështu një shkelje kushtetuese, duke i dhënë Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore një kompetencë që nuk e ka, as me ligjin nr. 27/2018, dhe as mundet që ta kryejë, kjo nisur dhe për nga kriteret që përcaktojnë emërimin e anëtarëve në këtë organ (KKMPK).

Vetë VKM nr. 625, datë 04.09.2019, bie ndesh me Kushtetutën, dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të sipërcituar.

Referuar të gjithë këtyre mangësive, është qartësisht e dallueshme se përmbushja e një qëllimi të mirë në këtë rast, do të përkonte detyrimisht përmes ndjekjes së këtyre hapave paraprakë:

- Realizimit të ndryshimeve ligjore në nenin 40, të ligjit nr. 27/2018, duke përfshirë në përmbajtjen e këtij neni edhe një kompetencë të re për Këshillin Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore me qëllim që ky i fundit të kishte një bazë ligjore për të kryer procesin administrativ të dhënies së statusit “Partner Strategjik”;
- Pas ndryshimeve ligjore dhe hyrjes në fuqi të tyre, do duhej që Këshilli i Ministrave më pas të miratonte, shtonte apo ndryshonte, si VKM-në nr. 279, datë 02.05.2019 “*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore*”, ashtu dhe VKM-në nr. 625, datë 04.09.2019 “*Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit*”, në mënyrë që të garantonte nga njëra anë kriteret me të forta për të garantuar pjesëmarrje cilësore në anëtarësinë e KKMPK-

¹⁴ Vendimi nr. 29/21 i Gjykatës Kushtetuese.

së, dhe nga ana tjetër bazë të plotë ligjore që ky organ të mund të merrte në shqyrtim një kërkesë dhe të vendoste për të dhënë statusin “Partner Strategjik”.

Në kushtet kur këto procese vendimmarrëse, legislative, e rregulluese nuk janë kryer, për gjithë sa parashtrua më sipër, dhe në mungesë të autorizimit të shprehur prej ligjit, i gjithë ky proces është absolutisht i pavlefshëm, dhe Kuvendi i Shqipërisë, së bashku me shqyrtimin e këtij dekreti për kthimin e ligjit nr. 50/2022, duhet të ndërmarrë njëkohësisht dhe nismën ligjvënëse të nevojshme.

Presidenti i Republikës, vlerëson të theksojë se, për shkak të historikut të bashkëpunimit shumë të mirë ndër dekada me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim apo ish-Fondin Amerikan të Ndërmarrjeve, cilësia e bashkëpunimit dhe produkteve të arritura, a poriri shkojnë drejt bindjes se përzgjedhja si partner strategjik është e mirëpritur, por kjo ndjesi e gjithëpranuar, përkundrejt këtij organizimi, dhe dhënia e këtij titulli duhet të shoqërohet përmes ndjekjes dhe vendimmarrjes së një procesi të rregullt ligjor, pa anashkalime, dhe përmes zbatimit korrekt të normave në fuqi, ku çdo organ duhet të veprojë brenda tagrave dhe kompetencave që njeh ligji, dhe që i jep apo dikton Kushtetuta.

Kjo pasi ushtrimi i një kompetence përtej ligjit dhe të paparashikuar prej tij, përpos vullnetit të mirë, mund të cenojë gjithë procesin dhe të krijojë këto situata të papëlqyeshme dhe që sjellin debat të gjerë dhe të pamerituar publik.

III. Mbi rolin e shtetit sa i takon mënyrës së administrimit të kësaj pasurie kulturore dhe rrezikun e cenimit të parimeve themelore kushtetuese për mbrojtjen e identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore kombëtare

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 3 të saj, parashikon se:

“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”

Populli Shqiptar ka vendosur trashëgiminë kombëtare si një nga parimet themelore, mbi bazën e të cilit ngrihet dhe funksionon shteti. Nëpërmjet institucioneve të tij, nga ai më i larti në hierarkinë shtetërore deri tek institucioni më i ulët i administrimit të funksionit publik, shteti ka për detyrë ta respektojë dhe ta ruajë këtë parim, si gjithë parimet e tjera të parashikuara në Kushtetutë.

Parku Kombëtar i Butrintit gëzon mbrojtje të drejtpërdrejtë nga Kushtetuta dhe aktet e tjera të institucioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka aderuar dhe ratifikuar.

Por ndërkohë, mënyra, procedura, dhe vendimmarrja që është ndjekur dhe se si është vendosur të administrohet kjo pasuri me vlera të tilla universale, është një çështje që veç të tjerash, ka hapur debat të madh publik, dhe përveç sa më sipër parashtruar, ligji nr. 50/2022, vlerësohet se bie në kundërshtim të hapur dhe me objektivat sociale që Kushtetuta ka përcaktuar **në nenin 59, pika 1, germa “g”**, të saj, në të cilën parashikohet se shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, **synon mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore.**

Kjo për arsye se:

1. Në praktikën parlamentare të publikuar në faqen e Kuvendit të Shqipërisë¹⁵, rezultojnë që përveç tekstit të marrëveshjes së miratuar përmes ligjit nr. 50/2022, objekt shqyrtimi, gjendet i publikuar dhe dokumentacioni tjetër ligjor apo teknik i miratuar që i paraprin kësaj marrëveshjeje.

Ndër to dhe Marrëveshja për themelimin e fondacionit të posaçëm për administrimin indirekt të Pasurisë Kulturore, ku referohet se, shteti do të vazhdojë të luajë rolin e tij lidhur me pasurinë kulturore të Butrintit nëpërmjet: - *Përfaqësimit në Bordin e Drejtorëve të Fondacionit*. Ky bord përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 anëtarë janë përfaqësues të shtetit shqiptar, dy anëtarë janë përfaqësues të Fondacionit Shqiptaro- Amerikan për Zhvillim dhe një anëtar është ekspert i jashtëm ndërkombëtar. Eksperti i jashtëm është zoti Richard Hodges-përzgjedhur nga Ministria e Kulturës.

1.1 Referuar nenit 8 “Bordi i Drejtorëve dhe përbërja”, të Aktit të Themelimit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, të datës 11.6.2021, **përbërja e Bordit të Drejtorëve është përcaktuar në mënyrë nominale** me emër të mbiemër dhe duke përcaktuar njëkohësisht dhe funksionin që mban anëtari i Bordit si përfaqësues/drejtues i secilës prej palëve pjesëmarrës (Ministria e Kulturës dhe AADF).

Ky përcaktim, së bashku me përcaktimin e bërë në pikën 8.2, të këtij Akti Themelimi, ku përcaktohet se: “*Kryetar i Bordit për mandatin e parë (dy vjeçar) do të jetë Ministri i Kulturës*”, lë hapësira që më tej, përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, edhe të mund të humbasë të drejtën e drejtimit të Bordit të Drejtorëve, si organi më i lartë vendimmarrës i Fondacionit.

Pra pas kalimit të dy viteve dhe aplikimit të pikës 8.2, të aktit të themelimit, zonja Elva Margariti e cila pas dy viteve apo në çdo moment më herët mund ta humbasë postin politik të Ministrit të Kulturës, mund të vijojë të qëndrojë si anëtare e Bordit të Drejtorëve sipas nenit 8, pika 1, të Aktit të Themelimit.

¹⁵ <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/55724>

Kjo paqartësi në formulimin e dispozitës së aktit të themelimit, e krijon këtë mundësi, duke bërë që të gëzojnë cilësinë e anëtarit të Bordit persona që nuk përfaqësojnë më autoritetin shtetëror.

1.2 Sipas pikës 5, të VKM-së nr. 625/2019: *“Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore merr masa të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të ndaluar çdo zhvillim apo veprimtari brenda dhe jashtë territorit të pasurisë kulturore publike që mund të ketë ndikim negativ për pasurinë kulturore publike apo që pengon administrimin efektiv nga fondacioni dhe/ose që ndalohen nga plani i menaxhimit, kur nga masat e marra nga fondacioni sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjes së administrimit nuk është arritur të shmangen ngjarjet e sipërpërmendura.”*

Ndërsa sipas pikës 6, të këtij vendimi: *“Në ushtrim të funksioneve për mbështetjen dhe garantimin e ruajtjes së vlerave kulturore të pasurisë, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore monitoron dhe vlerëson periodikisht veprimet e fondacionit në zbatim të marrëveshjes së administrimit dhe rregullat e monitorimit të miratuara nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në përfundim të monitorimit, fondacionit i dorëzohet raporti i monitorimit me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.”*

Në rastin konkret, përmes nenit 8, të Aktit të Themelimit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, të datës 11.6.2021, përbërja e Bordit të Drejtorëve është bërë në mënyrë nominale (emër mbiemër), ku Ministria e Kulturës që përfaqëson dhe shtetin shqiptar në këtë marrëveshje, **është në minorancë në raport me,**

- jo vetëm me anëtarësinë aktuale të Bordit të Drejtorëve; por edhe me
- mundësinë e hapur të shtimit të donatorëve dhe bërjes së tyre pjesë e Fondacionit që do të menaxhojë Butrintin, pa kaluar më, përmes kontrollit dhe miratimit të Kuvendit.

Në këto kushte, Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, përmes akteve që ka nënshkruar, është në pamundësi për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara në ligj, por dhe ato që specifikon pika 5 dhe 6, e sipërcituar e VKM-së nr. 625/2019.

Niveli i përfaqësimit të shtetit në Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit që është krijuar dhe synon të operojë sipas marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 50/2022, është i dobët, dhe jo në përputhje me atë që realisht po ofron shteti.

Në fund të ditës, shteti shqiptar po ofron për menaxhim dhe administrim një nga pasuritë e tij kulturore më të rëndësishme, dhe përfaqësuese të denjë të origjinës, identitetit kulturor të popullit shqiptar. Ndaj nuk mundet kurrsesi që menaxhimi i kësaj pasurie të një rëndësie kaq të veçantë, t'i besohet në shumicë vendimmarrëse (as të barabartë) subjekteve private.

1.3 Edhe sikur në raport të aktivitetit ekonomik apo pjesëmarrjes financiare të secilës palë të bëhej ky vlerësim, duket se raporti i përfaqësimit të shtetit në këtë fondacion është i përmbysur në

disfavor të palës shtet. Edhe duke mbajtur në konsideratë mbështetjen financiare që po ofrohet nga partneri (AADF) afërisht 5 milionë dollarë, ky kontribut në raport me vlerën universale të pasurisë, vlerën ekonomike, si studimin dhe të ardhurat e pritshme apo ato aktuale që realizon Parku Kombëtar i Butrintit, do të duhet të vinte palën shtet në pozitë vendimmarrëse dominuese.

Kjo për arsye se, mbështetja financiare që i jepet shtetit për këtë pasuri (pra rreth 5 milionë dollarë), është gjithmonë një mbështetje e sigurueshme nga vet shteti, apo çdo donator filantrop për pasuri të kësaj natyre, pa qenë nevoja për kalimin e kompetencave të tilla ekskluzive të administrimit.

Prandaj kjo çështje me të drejtë ka shqetësuar gjithë opinionin publik, e veçanërisht emra me zë të arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore shqiptare. Presidenti i Republikës çmon se ka vend dhe duhet të ri diskutohet në Kuvendin e Shqipërisë, me qëllim që kjo mangësi të riparohet, nëse kjo formë bashkëpunimi do të qëndrojë në fuqi për zbatim.

1.4 Për më tepër që, edhe pse në Ministrinë e Kulturës parashikohet të ngrihet një njësi për monitorimin e veprimtarisë së Fondacionit, vetë marrëveshja nuk përcakton qartë çështjet që do të duhet t'i nënshtrohen monitorimit për një pasuri me vlera të tilla kombëtare dhe universale.

1.5 Nga ana tjetër, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, sipas aktit të themelimit 11.6.2021, si dhe kontratës që propozohet të miratohet në Kuvend përmes ligjit nr. 50/2022, ka marrë përsipër të drejta shumë të rëndësishme, si e drejta për “*Kërkime arkeologjike dhe zbulimi në funksion të pasurisë kulturore dhe më gjerë*”.

Pra përmes këtij bashkëpunimi, funksionet e tij themelore, shteti i nxjerr nga përgjegjësia dhe e drejta ekskluzive e tij dhe i delegon tek një palë e tretë, ku edhe pse me pjesëmarrjen e tij, sërish pozita që ka pranuar t'i japë vetes, nuk ka fuqi kontrolluese siç e kërkon kjo çështje me rëndësi kombëtare.

1.6 Për më tepër, një tjetër problematikë është se përmes kësaj forme të zgjedhur për administrimin e kësaj pasurie dhe referuar marrëveshjes së nënshkruar, **shmanget tërësisht kontrolli i shtetit që realizohet nga autoritete të pavarura kushtetuese mbi të ardhurat që do të gjenerohen nga një pasuri kombëtare me vlera universale.**

Sipas akteve të themelimit dhe marrëveshjes së bashkëpunimit me Fondacionin e Menaxhimit të Butrintit, shteti vendos në dispozicion të fondacionit një nga pasuritë e tij më të rëndësishme me vlerë universale, dhe që sipas akteve të themelimit, nenit 5, pika 1, shkronja “o”, **Fondacioni ka jo vetëm administrimin, por merr dhe të drejtën që pasurinë kulturore ta japë në përdorim tek të tretë me synimin rritje të të ardhurave.**

Ndërkohë që objekt i kësaj marrëveshjeje është ndër të tjera dhe dhënia në administrim e një pasurie publike, me qëllim rritjen e të ardhurave për ta përmirësuar atë, atëherë kurrsesi nuk mund të shmanget kontrolli nga autoriteti më i lartë shtetëror që është Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Referuar ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe ligjit nr. 8788/2001 “*Për organizatat jofitimprurëse*”, organizatat jo fitimprurëse, si iniciativa private, nuk mund të jenë dhe nuk janë përfshirë në rrethin e subjekteve aktiviteti i të cilave mund të jetë objekt auditimi nga KLSH. Ky rregull është i përcaktuar në nivel ligji. Ndërsa Kushtetuta, neni 163, përcakton se:

“Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon:

- a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë;*
- b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;*
- c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.”*

Pra, kjo hapësirë që krijon ligji themeltar i shtetit në raport me formën hibride të zgjedhur për organizimin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit ku shteti është bashkëthemelues, kërkon dhe mundëson që përderisa marrëveshja me këtë fondacion miratohet po me ligj, si rregull përjashtimor krijon hapësirën që veprimtaria ekonomiko- financiare e kësaj veprimtarie që kryhet nga një formacion hibrid shtet-privat, të mund të kontrollohet jo vetëm përmes auditimit dhe monitorimit nga ministria përgjegjëse dhe kompani audituese të huaja, **por edhe nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Sipas akteve të miratuara, qoftë ato të themelimit, apo marrëveshjes së lidhur, monitorimi i veprimtarisë ekonomike, do të kryhet nga vet Ministria e Kulturës që është dhe përfaqësuese dhe anëtare e Bordit, e cila vlerëson dhe monitoron Administrimin e Pasurisë Kulturore nga Fondacioni në bazë të raportimit të tij dhe që **ka mundësinë, por jo detyrimin** që të ushtrojë kontroll në vend për vlerësimin e gjendjes së konservimit të raportuar nga Fondacioni, në prani të një përfaqësuesi të autorizuar.

Ndërkohë që në marrëveshjen që është miratuar me ligjin nr. 50/2022, (neni 26, pika 3) parashikohet se: “*Fondacioni do të prokurojë punë dhe shërbimet, si më sipër në përputhje me procedurat e veta të brendshme dhe Praktikën e Mirë të Industrisë dhe të ruajë dokumentacionin përkatës për secilën procedurë për efekt **auditimi nga kompani të auditit ndërkombëtar të radhës të renditura sipas publikimeve ndërkombëtare përkatëse.***”

Presidenti i Republikës, vlerëson se edhe kjo çështje kërkon vëmendje të veçantë nga Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që pasuria kulturore me vlera universale si Parku Kombëtar i Butrintit dhe gjithë zonat e tij, ashtu dhe veprimtaria ekonomiko-financiare, përdorimi i të ardhurave, mënyra e shfrytëzimit të tyre në funksion të qëllimit, t'i nënshtrohet një procesi auditimi sa më objektiv që të garantojë kontroll dhe transparencë të plotë, objektiv, që shmang çdo situatë të mundshme papajtueshmërie, abuzimi, shpërdorimi, apo të konfliktit të interesave, duke përfshirë pjesë të këtij procesi dhe përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

IV. Mbi mungesën e konsultimit dhe marrjes së ekspertizës së pavarur dhe objektive nga ekspertët vendas dhe zyra e UNESCO-s.

Ky ligj, është miratuar në mungesë të theksuar të konsultimit dhe marrjes së vlerësimeve dhe mendimeve të aktorëve dhe ekspertëve të fushës, që në fazat fillestare të propozimit nga fondacioni për këtë mënyrë të përzgjedhur administrimi.

1. Referuar dhe Raportit të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, të datës 26.4.2022¹⁶, deputetja Ina Zhupa e cila ka qenë dhe në cilësinë e bashkërelatores në këtë komision gjatë diskutimit të këtij projektligji, me të drejtë e ka ngritur këtë shqetësim dhe ka propozuar edhe **thirrjen në seancë dëgjimore të ekspertëve: z. Neritan Ceka, z. Agron Alibali, z. Kreshnik Merxhani, z. Auron Tare dhe të çdo eksperti tjetër që mund të propozojë secili nga anëtarët e komisionit, që të shprehin opinionet e tyre për këtë çështje, për nevojën që mund të ketë Butrinti për një menaxhim të ndryshëm [...].**

Kjo kërkesë dhe ky propozim nuk është marrë në konsideratë nga shumica në këtë komision, edhe pse çështja paraqet interes të lartë publik dhe kërkon njohuri të posaçme, jo të një por të disa fushave. As në Komisionin për Ekonominë dhe Financat nuk janë thirrur ekspertë që mbulojnë fushën dhe veprimtarinë për këtë çështje.

Ky është një fakt i pakundërshtueshëm, pasi deputeti relator në një nisëm legjislativ ka njohuritë më të thelluara mbi çështjen dhe kryen relatimin e saj.

Kur deputeti relator paraqet kërkesën për thirrjen dhe realizimin e një dëgjese me ekspertë dhe individë me njohuri të thelluara mbi çështjen që trajtohet, është në detyrimin e anëtarëve të Komisionit që kjo kërkesë e relatorit të përmbushet, ose së paku të parashtrahet për diskutim dhe vendimmarrje në Komision sipas nenit 36, të Rregullores së Kuvendit ku parashikohet se:

“1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë,

¹⁶ <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/55724>

përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim. “

Në Raportin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, të datës 26.4.2022, përmendet vetëm fakti se relatorja Ina Zhupa, e parashtrori kërkesën për kryerjen e dëgjësës publike, ndërkohë që nuk sqarohet nëse kjo kërkesë ju nënshtrua ose jo votimit, dhe cila qe arsyeja që kjo kërkesë është rrëzuar.

Presidenti i Republikës, vlerëson se mos marrja në konsideratë e kësaj kërkesë i ka hequr mundësinë këtij komisioni dhe Kuvendit që të njihet me fakte e detaje që hedhin dritë më shumë nga sy objektivë dhe të pavarur mbi këtë çështje, çka mund të ndihmonte vendimmarrjen e deputetëve.

Asgjë e keqe nuk mund t'i vijë Kuvendit të Shqipërisë nga debati, konsulta, oponenca dhe transparenca, sidomos në çështje karakteri i të cilave është sa delikat dhe teknik, me detaje që nuk mund të njihen nga deputetët që nuk kanë të njëjtën fushë ekspertize, por kaq i rëndësishëm sa i takon interesit kombëtar dhe trashëgimisë sonë.

Kjo mangësi është theksuar dhe është diskutuar edhe në seancën plenare të datës 23 maj 2022, ku është diskutuar dhe miratuar ligji nr. 50/2022¹⁷.

Ndaj duke konstatuar këtë mangësi në procesin e shqyrtimit të nismës, Presidenti i Republikës, vlerëson se kjo duhet riparuar dhe Kuvendi i Shqipërisë, pasi të rivlerësojë nismën duhet të kryejë dëgjësja dhe konsultim publik me grupe apo aktorë që realisht e njohin dhe janë ekspertë të kësaj çështje, duke përfshirë por pa u kufizuar në arkeologë, historianë, zoologë, botanistë, hartografë, inxhinierë, ekspertë të trashëgimisë, etj.

2. Përgjatë shqyrtimit të praktikës parlamentare, rezulton se në mbledhjen e Komisionit të Politikës së Jashtme, të datës 10 maj 2022 përgjatë shqyrtimit dhe dhënies së përgjigjeve, Ministrja e Kulturës është shprehur ndër të tjera edhe mbi komunikimin shkresor konsultativ me zyrën e UNESCO-s. Në raportin e këtij Komisioni të datës 10 maj 2022, rezulton se Ministrja Margariti është shprehur se:

“[...] kjo nisëm ka ardhur pas konsultimeve të gjera dhe intensive me personalitete dhe institucione të rëndësishme vendase dhe ndërkombëtare. Përfshirë këtu edhe UNESCO-n [...] .”

¹⁷ <https://www.parlament.al/Procesverbale/Details/12840>

Gjithashtu, dhe në Raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të datës 13 maj 2022, citohet se:

“Ministrja nënvizoi se projektligji është konsultuar me UNESCO dhe sqaroi se mbi bazën e marrëveshjes, Butrinti do të menaxhohet nga një fondacion i posaçëm, jo fitimprurës, i bashkë-themeluar midis Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), i cili do të funksionojë sipas ligjit shqiptar për OJF-të dhe sipas kompetencave që i jep ligji nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” [...].

Pra, qëllimi i vetëm i Fondacioni është mirëmenaxhimi i aseteve të Parkut Kombëtar të Butrintit, që është pasuri botërore nën mbrojtjen e UNESCO-s dhe respekton të gjitha rekomandimet e rëndësishme të mirëcaktuara dhe mirëkoordinuara me UNESCO-n që në fazën e planit të menaxhimit të integruar, duke sqaruar se[...] “;

Nga shqyrtimi i plotë i praktikës parlamentare të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit për këtë projektligj¹⁸, një raportim i tillë **nuk mbështetet me dokumentet respektive që të faktojnë komunikimin me zyrën e UNESCO-s**, për të cilën zonja Margariti ka deklaruar në komisionet parlamentare se këtij organizmi i është marrë mendim.

Ky komunikim do të duhej të ishte depozituar në komisionet respektive në Kuvend, dhe të shoqëronte detyrimisht këtë nismë legislative. Pra, pjesë e praktikës duhet të ishte jo vetëm përgjigja që zyra përkatëse e UNESCO-s ka dhënë, nëse një komunikim i tillë është kryer, por e gjithë praktika e këtij komunikimi që do të duhej të përfshinte në mënyrë transparente se çfarë informacioni apo kërkesë i ka parashtruar qeveria shqiptare Zyrës së UNESCO-s, dhe cila apo cilat kanë qenë përgjigjet e dhëna prej këtij organizmi ndërkombëtar. Në rast se ky komunikim, nëse ekziston, do të ishte bërë transparent, atëherë kjo do të ndihmonte shumë dhe për vlerësimin e drejtë të çështjes nga deputetët dhe opinioni publik.

3. Nga shqyrtimi i diskutimeve dhe relacioneve në Komisione, çështje thelbësore janë trajtuar përciptazi, ndërkohë që Kuvendi duket sikur më shumë i ka kushtuar rëndësi kësaj çështjeje sikur të ishte vetëm dhënia në administrim e një pasurie për veprimtari ekonomike. Por shqetësimet që shtrohen për diskutim janë të një karakteri shumë herë më të madh, që lidhen me identitetin kombëtar, ruajtjen dhe promovimin e vlerave kombëtare dhe pasurisë universale të Parkut Kombëtar të Butrintit, pra thelbësisht me çështje që ndikojnë në atë që konsiderohet pasuri botërore.

Kjo qasje e gabuar e Kuvendit është e qartë, për sa kohë dhe shqyrtimi i kësaj nisme legislative është bërë në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave në cilësinë e komisionit përgjegjës, që është ndalur më së shumti në aspekte ekonomike të nismës, duke lënë mënjanë rëndësinë e kësaj pasurie me vlera kulturore universale.

¹⁸ <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/55724>

4. Siç kam përmendur në hyrje të këtij arsytimi, nisma ka ngjallur debate të forta publike dhe ka çuar deri në kërkesa të administruara zyrtarisht pranë Institucionit të Presidentit të Republikës, për mos dekretimin e ligjit.

Një prej këtyre shqetësimeve, përcjellë zyrtarisht pranë Presidentit të Republikës është dhe letra nr. 1978 prot., datë 27.05.2022, e deputetes së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Ina Zhupa, administruar me nr. 1830 prot., datë 27.5.2022. Përmes kësaj letrë deputetja ka parashtruar një kërkesë të mirë argumentuar për mos dekretimin e ligjit “*Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit*”.

Në këtë letër, të cilën e gjeni si pjesë përbërëse të këtij arsytimi **Shtojca nr. 2** (dhe kopje bashkëlidhur e letrës), në mënyrë të përmbledhur pasqyrojmë se znj. Zhupa argumenton se ky ligj:

- *Është antikushtetues sepse bie në kundërshtim me Konventën e Parisit 1972.*
- *Ligji është formë koncensionare, e cili prodhon një model të administrimit privat me të drejta të plota mbi Butrintin.*
- *Modelet e paraqitura nga ministria si referencë për menaxhimin e Butrinti nuk kanë asnjë të përbashkët me Ligjin. Ky është një model që nuk ekziston në asnjë vend të botës.*
- *Ligji ndan në dy pjesë menaxhimin e parkut, në kundërshtim me përcaktimet e UNESCO-s për menaxhimin si një i tërë. Kjo ndarje hap rrugë për ndërtime brenda dhe jashtë zonës A3.*
- *Mungesa e dokumentacionit nga UNESCO dhe ICOMOS*
- *Ligji rrezikon historinë shqiptare dhe identitetin kombëtar shqiptar.*

Të gjitha këto shqetësime që në mënyrë të përmbledhur paraqiten më sipër dhe që janë ngritur në letrën e deputetes Zhupa të argumentuara në mënyrë konkrete, nisur nga të metat e konsultimit të munguar për këtë çështje dhe mungesa e transparencës në këtë proces, vlerësohet se duhet të merren në shqyrtim dhe t'i nënshtrohen diskutimit prej deputetëve dhe strukturave të Kuvendit, përgjatë rishqyrtimit të nismës.

5. Një tjetër figurë publike, një shqiptaro-amerikan i njohur me reputacion ndërkombëtar dhe me peshë, një nga aktivistët e njohur i cili ka qenë për 25 vite me radhë anëtar i Bordit të Fondit Amerikan të Ndërmarrjeve (AAEF) dhe Fondacionit Shqiptaro- Amerikan për Zhvillim (AADF), zoti Boga, ka mbajtur disa qëndrime publike¹⁹, lidhur me marrëdhënien e shtetit shqiptar me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim dhe rolin e këtij fondacioni si në subvencionimin për mbështetje në hartimin e kuadrit ligjor të ri që mundësoi më pas draftimin e marrëveshjes objekt shqyrtimi (Ligjit nr. 27/2018 “*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*”), si dhe angazhimin e fondit dhe fondacionit pikërisht në Butrint, që pas viteve 1990, por dhe në vijimësi lidhur me partneritetin që tashmë është finalizuar përmes lidhjes së kontratës dhe miratimit të ligjit nr.

¹⁹ <https://www.voxnews.al/aktualitet/butrinti-cafo-boga-pas-doreheqjes-koha-per-ndryshimin-e-lidershipit-n-i8124>

50/2022 “Për miratimin e Marrëveshjes për administrimin e nënzonave të Trashëgimisë Kulturore dhe Peisazhit kulturor pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”²⁰.

Zoti Boga, i cili ka mbajtur funksionin si anëtar Bordi për 25 vite me radhë ²¹, në një qëndrim të tij të fundit të titulluar “Saga e Butrintit”, publikuar në datën 10.06.2022, në disa media elektronike dhe rrjete sociale²², ka shprehur rezervat dhe shqetësimet serioze të tij mbi nismën, mungesën e transparencës, ekperiencën e partnerit, mënyrën e administrimit të procesit e në veçanti mbi të dhëna që tregojnë për rreziqe që mund t’i vijnë Parkut të Butrintit nga ky proces, e për pasojë trashëgimisë kulturore shqiptare.

Qëndrimi i tij i plotë, është vlerësuar të përfshihet gjithashtu si pjesë e këtij arsyetimi (**Shtojca nr. 3**), edhe për të hedhur më shumë dritë mbi elementë që kanë shoqëruar procesin disa vjeçar deri në miratimin e ligjit nr. 50/2022, e që kërkojnë vëmendjen e Kuvendit dhe transparencë me publikun për mënyrën e vendimmarrjeve dhe administrimit të pasurisë kulturore shqiptare.

Ky qëndrim publik i një prej anëtarëve të Bordit të Fondacionit Shqiptaro Amerikan për Zhvillim, që është dhe partneri strategjik i përzgjedhur për bashkëpunim, paraqet një përmbledhje ekzekutive të të metave dhe mangësive të konstatuara në ndjekjen, përpilimin, hartimin, dhe miratimin e këtij plani të finalizuar me “Marrëveshjen për administrimin e nënzonave të Trashëgimisë Kulturore dhe Peisazhit kulturor pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

Konkretisht, këto mangësi mund të përmbliidhen në:

- **Mungesë e ekspertizës dhe vullnetit për të pasqyruar në dokumentet që janë hartuar për të reklamuar të vërtetat e Butrintit dhe për ta shfaqur atë në tregun botërore si një trashëgimi historike dhe kulturore shqiptare;**
- **Mungesë e transparencës në vlerësimin e partnerit strategjik, miratimit të planit, aktit të themelimit dhe të vetë marrëveshjes;**
- **Keqkuptim i projektit;**
- **Përvajtje të ekspertizës vendase;**
- **Zhënjim i publikut me AADF-në për përfshirjen e saj në zonat e trashëgimisë së Butrintit.**

Kjo dëshmi dhe qëndrim publik është thelbësore për të riparë edhe një herë me kujdes gjithë procedurën e ndjekur dhe për të vlerësuar çdo lloj nisme që lidhet me administrimin e një pasurie

²⁰ Zoti Cafo Boga, ka qenë anëtar i Bordit të AADF për 25 vite me radhë.

²¹ <https://telegرافي.com/cafo-boga-shqiptari-qe-kaperceu-te-gjitha-barrierat-dhe-realizoi-nje-histori-suksesi-ne-amerike/>

²² <https://www.politiko.al/e-tjera/cafo-boga-saga-e-butrintit-i461562>

https://telegرافي.al/aktualitet/cafo-boga-vazhdon-saga-lidhur-me-butrintin/?fbclid=IwAR2YoKbvX7YVwBDjxM7JkqxOkvlpMN6nyc_8n3XPA_1oI6SUYKhEgCi-Mg8

të tillë si Parku Kombëtar i Butrintit, në formën e propozuar, në raport me interesin më të lartë të shqiptarëve, mbrojtur nga Kushtetuta e vendit, për të gjetur dhe përzgjedhur atë që është më e mirë për vendin, dhe identitetin tonë kombëtar.

6. Mbi domosdoshmërinë për konsultimin e nismës dhe zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Parlamentit Evropian të datës 19 maj 2022.

Parlamenti Evropian në datën 19 maj 2022, ka miratuar me 519 vota, një Rezolutë për Shqipërinë²³. Në këtë Rezolutë Parlamenti Evropian përmes një gjuhe të drejtpërdrejtë dhe jo diplomatike, ka përshkruar në një skaner vlerësues situatën në vend, dhe ka përcaktuar njëkohësisht detyrat që priten të përmbushen nga Shqipëria në vazhdim, në mënyrë që rruga e anëtarësimit të vendit tonë në Bashkimin Evropian, të jetë sa më e shkurtër dhe e sigurtë. Kjo Rezolutë përmban ndër të tjera thirrje për respektimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut, çështjeve të jashtme etj. Në pikën 49 të kësaj Rezolute citohet se²⁴:

“49. Thekson se përmirësimi i qeverisjes, transparencës, sigurisë ligjore, përfshirja dhe dialogu social janë thelbësore për stimulimin e investimeve të huaja direkte dhe mbajtjen e punëtorëve të kualifikuar; bën thirrje për një përfshirje kuptimplotë të shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara në debatin mbi planet apo vendimmarrjet politike;”

Referuar çështjes në fjalë dhe fakteve të konstatuara e vlerësuara më sipër, rezulton se ky proces legjislativ që kulmon me miratimin e ligjit nr. 50/2022, bie ndesh dhe nuk respekton këtë kërkesë të Parlamentit Evropian, edhe pse ky akt është miratuar në datë 19 maj 2022, **pra vetëm 4 ditë më parë se Kuvendi të miratonte në seancë plenare ligjin nr. 50/2022.**

Kjo mënyrë veprimi është tregues i qartë se dokumentet e organizmave më të lartë të Bashkimit Evropian, të miratuara nga një numër i lartë deputetësh dhe që duhet të jenë busull orientuese për gjithë organet e shtetit, përfshirë dhe Kuvendin e Shqipërisë, nuk shqyrtohen, nuk studiohen, dhe nuk merren në konsideratë. Mbase kjo për faktin se, si në rastin konkret, vendimmarrja është diktuar nga vullneti politik, dhe jo nga vullneti për të realizuar me transparencë zgjidhjen më të mirë.

Ndaj edhe në respekt të Parlamentit të Bashkimit të Evropian, dhe për plotësimin e rekomandimeve të dhëna jo vetëm në pikën 49, por në tërësinë e kësaj Rezolute prej 73

²³ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2022-0214_EN.html

²⁴ Pika 49, e Rezolutës më gjuhën angleze citon se: “49. Stresses that improved governance, transparency, legal certainty, inclusion and social dialogue are essential for stimulating foreign direct investment and the retention of skilled workers; calls for a meaningful inclusion of civil society and other relevant stakeholders in the debate over policy actions;”

pikash, si President i Republikës, nuk mund ta pranoj dekretimin e ligjit nr. 50/2022, ndërkohë që shkelja e procedurave dhe mungesa e konsultimit gjithëpërfshirës dhe kuptimplotë janë më se evidente që nuk janë përmbushur.

7. Mbi shqyrtimin e nismave paralele ligjvënëse që lidhen me themelin e çështjes

Një arsye tjetër se përse ky ligj i duhet kthyer Kuvendit për rishqyrtim është dhe fakti se, aktualisht në Kuvendin e Shqipërisë rezulton i depozituar një propozim për ndryshime ligjore në datën 11.05.2022, nga deputetja zonja Ina Zhupa²⁵, e grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Konkretisht kjo nismë propozuese legjislative synon ndryshimin e neneve 171, 172, 173 të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, pikërisht të asaj baze ligjore mbi të cilën Ministria e Kulturës dhe Këshilli i Ministrave janë mbështetur për të hyrë në një marrëdhënie të tillë bashkëpunimi me qëllim finalizimin e saj përmes krijimit të një entiteti të posaçëm si Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Kjo nismë legjislative është propozuar në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe Presidenti i Republikës, duke e konstatuar si fakt, nuk mund ta lerë jashtë vlerësimit këtë aspekt të rëndësishëm, i cili lidhet drejtpërdrejtë me respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike, apo barazisë përpara ligjit.

Një nismë e tillë, argumentuar si nevojë për të amenduar ligjin në mbrojtje të pasurisë e trashëgimisë kulturore, sigurisht që duhet shqyrtuar paraprakisht, së bashku me rekomandimet e dhëna në këtë arsyetim për nevojën për ndryshime apo përmirësime të nenit 40, të ligjit nr. 27/2018, dhe akteve të tjera nënligjore derivat të tij, përpara nënshkrimit të marrëveshjeve bashkëpunuese të lidhura në këtë proces.

Në eventualitetin e miratimit të nismës së deputetes sipas përmbajtjes së projektligjit të propozuar prej saj, duke hequr apo rregulluar kërkesat ligjore që lidhen me mundësinë që ofron ligji për krijimin e fondacioneve të kësaj natyre shtet-privat, atëherë kjo prek drejtpërsëdrejti edhe Marrëveshjen e përcjellë për miratim përmes ligjit nr. 50/2022.

Prandaj ky projektligj duhet të shqyrtohet paraprakisht apo minimalisht paralelisht me ligjin objekt shqyrtimi, sepse ka rëndësi themeltare për çështjen, apo fatin e saj.

²⁵ <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/55728>

V. Mbi respektimin e shtetit të së drejtës

Duke konstatuar gjithë këto problematika e çështje që meritojnë vëmendjen e duhur prej Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, Presidenti Republikës, vlerëson të evidentojë se për çështje kaq të ndjeshme për publikun dhe kaq të rëndësishme për identitetin dhe vlerat e pasurive tona kombëtare që tashmë janë dhe pjesë e pasurisë kulturore universale, siç është Parku Kombëtar i Butrintit, organet publike duhet të tregojnë maturi në veprimtarinë dhe vendimmarrjet e tyre, duke shteruar të gjitha faktet historike, argumentet, ku çdo mendim i specializuar duhet të ballafaqohet me vullnetin politik, përmes studimeve dhe vlerësimeve shteruese shkencore, teknike dhe ligjore, që produkti i një nisme politike të finalizohet në mënyrën më të mirë, dhe kurrësi të mos krijojë asnjë hapësirë që do të mund të linte edhe dyshimin më të vogël se pasuria që përfaqëson trashëgiminë dhe vlerat historike kombëtare mund të cenohet.

Është vendi, që të ri sillet në vëmendjen tuaj ajo që vetë Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të saj ka shprehur në këtë drejtim për çështje që lidhen me identitetin dhe pasurinë kulturore. Në vendimin nr. 29/2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është shprehur ndër të tjera se²⁶:

“[...] neni 3 i Kushtetutës, i cili përcakton identitetin dhe trashëgiminë kombëtare, si një prej bazave që shteti ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë. Nga ana tjetër, ky detyrim kushtetues i organeve shtetërore është i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me parimin e shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

90. Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përcakton një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues (shih vendimin nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (shih vendimet nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 25, datë 28.04.2014; nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

91. Në vijim të kësaj jurisprudence, Gjykata thekson se të gjitha organet, e parashikuara ose jo në Kushtetutë, duhet t’i nënshtrohen parimit të kushtetutshmërisë dhe atij të ligjshmërisë, pasi vetëm në këtë mënyrë garantohet shteti i së drejtës. Duke mbajtur parasysh se shteti ka për detyrë respektimin dhe mbrojtjen e bazave (vlerave themelore) të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë, Gjykata nënvizon se organet shtetërore në aktet që miratojnë dhe në veprimet që kryejnë, nga njëra anë, duhet të frymëzohen nga këto vlera themelore (neni 3), por, nga ana tjetër, ato njëkohësisht duhet të respektojnë shtetin e së drejtës, pra që veprimtaria e tyre të jetë e bazuar tek e

²⁶ Vendimi nr. 29/2021 i Gjykatës Kushtetuese.

drejta në kuptimin e gjerë (latu sensu), e cila përfshin jo vetëm Kushtetutën, por edhe kuadrin ligjor respektiv (neni 4). Megjithatë, shteti i së drejtës nuk konsiston vetëm në detyrimin për zbatimin e tërësisë së normave juridike, nga organet shtetërore, por në **sigurimin e kontrollit gjyqësor se si autoritetet respektojnë këto norma juridike.**

92. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim bazat (vlerat themelore) e përcaktuara në nenin 3 të Kushtetutës, ku përfshihen edhe identiteti, edhe trashëgimia kombëtare, shërbejnë për të interpretuar normat kushtetuese dhe veprimtarinë e organeve shtetërore, ndërsa parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të saj, shërben për të përvijuar dhe kontrolluar veprimtarinë e këtyre organeve.

94. Identiteti kombëtar dhe kultura janë përmendur shprehimisht në preambulën e Kushtetutës, ku përcaktohet: “Ne, populli i Shqipërisë (...) me zotimin për (...) prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën (...) me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar.”. Gjithashtu, ai, së bashku me trashëgiminë kombëtare garantohet edhe në nenin 3 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”.

95. Rëndësia dhe roli i identitetit kombëtar në rendin juridik rrjedh nga fakti që ai garantohet që në preambulën e Kushtetutës e cila formulon qëllimet e kushtetutëbërësit dhe është shprehje e vullnetit të popullit (shih vendimin nr. 20, datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese). **Për këtë arsye identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare parashikohen në nenin 3 të Kushtetutës, që përcakton se shteti ka për detyrë të mbrojë dhe të respektojë bazat e përcaktuara në të, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse vlera themelore, pra që qëndrojnë në themel të organizimit shtetëror.** Për më tepër që trashëgimia kombëtare dhe kulturore, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, përbën një nga objektivat socialë, që shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon të mbrojë.

96. Identiteti kombëtar ka të bëjë me veçoritë ose tiparet dhe përkatësinë në to të një bashkimi njerëzish në një komb ose në një shtet, individët e të cilit kanë ndjesinë e përbashkët të përkatësisë së një origjine e prejardhjeje të njëjtë, race, territori, gjuhe, tradite, feje, historie ose kulture të përbashkët. Përveç këtyre veçorive ose tipareve, pjesë të identitetit kombëtar janë edhe simbolet dalluese të një shteti apo kombi, të tilla si flamuri, stema, himni, ose simbole të tjera dalluese, sipas rëndësisë që çdo bashkim njerëzish u ka dhënë simboleve të tyre, duke i bërë ato pjesë të identitetit kombëtar. Në këtë kuptim edhe Kushtetuta, në nenin 14 të saj, ka përcaktuar disa nga këto veçori dhe simbole, të cilat përbëjnë identitetin kombëtar shqiptar (gjuha, flamuri, stema, himni, kryeqyteti ose festa kombëtare e Republikës së Shqipërisë). Këto veçori apo tipare nuk janë të lindura, por janë produkte të krijuara ndër vite nga historia e kombit ose e

shtetit. Është pikërisht ndjesia e përbashkët që ka çdo bashkim individësh për këto veçori ose tipare që i bën ata të ndihen pjesë e identitetit kombëtar, që i bashkon dhe i dallon nga të tjerët.

97. Gjykata vëren se koncepti i trashëgimisë kulturore trajtohet edhe në instrumentet ndërkombëtarë. Kështu shprehja “pasuri kulturore” u përdor fillimisht në Konventën për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në Rastet e Konflikteve të Armatosura, të miratuar në Hagë në vitin 1954. Sipas kësaj Konvente, me “pasuri kulturore” do të kuptohet, pavarësisht origjinës ose pronësisë, çdo lloj pasurie e luajtshme ose e paluajtshme me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore të popullit, të tilla si monumente arkitekturore, të artit ose historisë, me karakter fetar ose laik; zonat arkeologjike; grupe ndërtesash të cilat, së bashku, shfaqin interes historik ose artistik; vepra të artit; dorëshkrime, libra dhe objekte të tjera me interes artistik, historik ose arkeologjik; përmbledhje shkencore, përmbledhje të rëndësishme librash ose arkivash apo riprodhime të pasurive të përshkruara më lart. Në këto pasuri përfshihen edhe ndërtesat, qëllimi kryesor i të cilave është ruajtja ose shfaqja e pasurisë së luajtshme, të përshkruara më lart, si: muzetë, libraritë e mëdha dhe arkivat, ose strehët e krijuara për ruajtjen, në rastet e konflikteve të armatosura, e pasurisë së luajtshme të përshkruar më lart; qendrat që përmbajnë numër të madh pasurish të luajtshme, të njohura ndryshe dhe si qendra monumentesh.

98. Edhe Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë, e datës 27 tetor 2005, e nënshkruar nga shteti shqiptar më 27.10.2005, **në preambulën e saj ka theksuar se vlerat dhe potenciali i trashëgimisë kulturore duhet të përdoret me mençuri nga shtetet, pasi janë burim i një zhvillimi të qëndrueshëm dhe cilësi e jetës në një shoqëri në zhvillim të vazhdueshëm. Kjo përbën një nga qëllimet e kësaj konvente, e cila, ndër të tjera, parashikon respektimin e integritetit të trashëgimisë kulturore, duke siguruar që vendimet për ndryshimin e tyre të merren përmes një procesi gjithëpërfshirës, si dhe përmes parashikimit të procedurave për zgjidhjen në mënyrë të drejtë të situatave, ku grupe të ndryshme të shoqërisë përcaktojnë vlera të ndryshme ndaj së njëjtës trashëgimi kulturore** (neni 7, shkronja “b” dhe neni 8, shkronja “a”).

101. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe, kur është e mundur, administrimi i saj kanë për qëllim, përveç ruajtjes së cilësisë së jetës, edhe kujdesin për burimet historike, kulturore dhe artistike të rajonit dhe banorëve të tij. **Për rrjedhojë, ato kanë vlera thelbësore, mbrojtja dhe promovimi i të cilave u përket autoriteteve shtetërore** (shih vendimet e GJEDNJ-së Kozacioğlu kundër Turqisë, 19 Shkurt 2009, § 54 dhe Kristiana LTD kundër Lituanisë, 6 shkurt 2008, § 104). Në këtë drejtim, autoritetet kombëtare gëzojnë një hapësirë vlerësimi në përcaktimin e interesit të përgjithshëm të shoqërisë (shih vendimet e GJEDNJ-së Beyeler kundër Italisë, 5 janar 2000, § 112; Ruspoli Morenes kundër Spanjës, 28 nëntor 2001, § 39).

102. GJEDNJ-ja, në lidhje me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë, e 27 tetorit 2005, të përmendur më sipër, ndër të tjera, është shprehur se ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe përdorimi i saj i qëndrueshëm kanë si qëllim zhvillimin njerëzor dhe cilësinë e jetës (shih vendimin e GJEDNJ-së Debelianovi kundër Bulgarisë, 29 qershor 2007, § 54).

103. Trashëgimia kulturore ka gjetur një trajtim të gjerë edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Italisë. Ajo është shprehur se kompetenca shtetërore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është e lidhur edhe me veçantinë e trashëgimisë historiko-artistike italiane, të formuar kryesisht nga vepra të krijuara gjatë më shumë se njëzet e pesë shekujve në territorin italian, të cilat janë shprehje dhe dëshmi e ngjarjeve historike të vendit. Ato duhet të konsiderohen si një e tërë, pavarësisht vlerës së një pasurie specifike, të veçuar nga të tjerat (shih vendimin nr. 9 të vitit 2004 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë). Mbrojtja e trashëgimisë kulturore përfshin para së gjithash, aftësinë për të njohur vlerat kulturore si të tilla. Nuk ka dyshim se midis vlerave që planifikimi urban duhet të mbrojë, kanë përparësi ato me rëndësi artistike, historike, dokumentare dhe kulturore (shih vendimin nr. 232 të vitit 2005 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë).

104. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se trashëgimia kulturore është pjesë e trashëgimisë së popullit, si dhe përbën kujtesën e prekshme dhe të paprekshme të asaj që njeriu ka krijuar (dhe vazhdon të krijojë) për pasardhësit e tij. Gjithashtu, ajo mund të quhet edhe dëshmi materiale që ka vlerën e civilizimit dhe bën pjesë në trashëgiminë kombëtare të një shteti, duke reflektuar jetën e komunitetit, historinë dhe identitetin e tij, si dhe lidhjen e së shkuarës me të tashmen e të ardhmen, si dhe konsiston në manifestime të jetës njerëzore, që dëshmojnë për vlerat, besimet, historinë dhe traditat e vendit dhe u japin qytetarëve ndjesinë e përkatësisë në një popull, që lidhet më pas me identitetin kombëtar.

105. Trashëgimia kulturore përbën një formë të veçantë të shprehjes së kulturës së popullit dhe përfshin çdo gjë që konsiderohet vendimtare për identitetin e një shoqërie ose vendi. Prandaj çdo ankesë ndaj cenimit të këtyre të drejtave duhet të zgjidhet duke vendosur në balancë interesat e palëve të prekura me interesin e përgjithshëm të shoqërisë, duke marrë gjithmonë në konsideratë aspektet morale, historike, kulturore, kombëtare, financiare dhe ligjore të përfshira. Gjetja e këtyre zgjidhjeve duhet të konsistojë në shkëmbim informacioni, konsultim, dialog dhe bashkëpunim mes palëve të përfshira.

106. Në vijim të këtij arsyetimi, mbi identitetin kombëtar, si dhe trashëgiminë kombëtare dhe kulturore, në vlerësimin e Gjykatës, detyrimi kushtetues për mbrojtjen dhe respektimin e tyre, i lidhur me parimin e shtetit të së drejtës, ka të bëjë me marrjen e masave nga ana e ligjvënësit për mbrojtjen e tyre, ashtu dhe me zbatimin në praktikë nga institucionet përkatëse të procedurave ligjore.

109. Nisur nga sa më lart, si dhe nga roli që trashëgimia kombëtare zë në Kushtetutë, është e qartë që nëpërmjet ligjit nr. 27/2018 parashikohet një proces ligjor, në themel të

të cilit qëndron detyrimi për një vlerësim të veçantë nëse objekte të caktuara hyjnë ose jo në trashëgiminë kulturore. Në këtë drejtim Gjykata vlerëson se ekspertizat që duhet të kryejnë institucionet kompetente për shpalljen e objekteve pjesë të trashëgimisë kulturore ose heqjen e këtij statusi, duhet të jenë objektive, duke treguar një kujdes të shtuar, koherencë në veprime dhe veprime të planifikuara. Këto kërkesa që duhet të karakterizojnë vlerësimin e veçantë marrin shkak nga rëndësia që ka identiteti kombëtar dhe trashëgimia kulturore. Prandaj, në rastet e debatueshme në vlerësimet që kryejnë institucionet duhet të mbizotërojë interesi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore për objektet e deklaruara si të tilla, pra të shterohen të gjitha mjetet dhe mundësitë për të bërë të mundur një gjë të tillë.”

Referuar këtij qëndrimi të Gjykatës Kushtetuese, ku ndërlihen bashkë si parimi i respektimit të shtetit të së drejtës dhe detyrimi për të ruajtur të pacenuar identitetin kombëtar, në krahasim me gjithë konstatimet dhe vlerësimet e përmendura më sipër; procedurën e ndjekur në këtë rast; mos konsultimi me ekspertë të fushës; kapërcimi i kufijve të vëna nga ligji; vendimmarrja e Këshillit të Ministrave apo të disa organeve të tjera për këtë proces (si KKMPK); nxitimi në negociimin e një marrëveshjeje për dhënien në administrim të një pasurie me vlera të tilla të trashëgimisë kulturore si parku i Butrintit; bëjnë që procesi i ndjekur dhe si rezultat dhe ligji nr. 50/2022 i miratuar të bjerë ndesh edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Ndërkohë që nga ana tjetër, si rezultat i të metave të konstatuara, mund të krijohet hapësirë që Parku Kombëtar i Butrintit të mos shfrytëzohet sipas qëllimit, duke shkaktuar kështu pasoja të rënda e të pariparueshme për interesin publik shtetëror dhe trashëgiminë kulturore kombëtare.

Në përfundim, jo vetëm qëndrimi publik i z. Cafo Boga, por dhe nën dritën e argumenteve të përcjella e të bëra publike nga deputetë apo ekspertë të fushës, mjaftojnë që marrëveshja e lidhur prej Ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe e miratuar përmes ligjit nr. 50/2022, të jetë e papranueshme për Presidentin e Republikës, pasi në formën e draftuar, konsultuar, ndërtuar, miratuar dhe që parashikohet për zbatim, kjo marrëveshje **nuk garanton**, përkundrazi krijon terren që të shkelen çështje të karakterit dhe rëndësisë më të lartë, si identiteti dhe trashëgimia kulturore kombëtare shqiptare, vlerat historike, mbrojtja, promovimi, lartësimi i popullit shqiptar, të cilat janë vlera kryesore që nuk mund të cenohen, e që merren në mbrojtje që në Preambulën e Kushtetutës, dhe në nenet 3, e vijues të saj, si parime themelore, vlera universal të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Ndaj nisur nga rëndësia e kësaj çështje, Presidenti i Republikës, në cilësinë e Kreut të Shtetit, dhe si përfaqësues i unitetit të popullit, konstatoj se mekanizmat kushtetues (pra mekanizmat *check & balance* mes ekzekutivit dhe legjislativit) në këtë rast nuk kanë funksionuar siç duhet, dhe si rezultat Kuvendi përmes miratimit të marrëveshjes së propozuar, me ligjin nr. 50/20202 ka ligjësuar një akt, që rrezikon

të përkeqësojë situatën e mbrojtjes ligjore që garanton ruajtjen, përmirësimin, promovimin e trashëgimisë sonë kombëtare, pavarësisht vullnetit të mirë të deklaruar.

Në këto kushte, dhe me përgjegjësinë dhe rolin që Kushtetuta më ka dhënë, referuar sa më sipër, me qëllim:

- respektimin e parimeve kushtetuese dhe vlerave universale;
- mbrojtjen e trashëgimisë tonë kombëtare nga shtrembërime të çdo lloj natyre;
- respektimin e Konventës së Parisit dhe parimeve të përcaktuara nga UNESCO;
- për të garantuar që rendi juridik i normave të legjislacionit shqiptar, është i njëjtë dhe i barabartë për të gjithë dhe askush nuk mund të ketë një trajtim të parapëlqyer nga qeveria nëpërmjet Kuvendit;
- për të mos lejuar asnjë mundësi që pasuria e shqiptarëve të keqadministrohet dhe pjesët më të rëndësishme të saj që faktojnë gjurmët reale të identitetit ilir dhe shtetit shqiptar të humbasin;
- në respekt të Rezolutës së Parlamentit Evropian për Shqipërinë të datës 19 maj 2022 dhe i bindur dhe mbështetës për gjithë sa parashtrohet në këtë Rezolutë;
- me qëllimin që pasuria dhe financat e shtetit që krijohen nga një pasuri kombëtare e patjetërsueshme, të administrohen në funksion të kësaj çështje në mënyrën më të mirë të mundshme;
- duke respektuar njëkohësisht dhe vullnetin dhe angazhimin prej vitesh të Fondacionit Shqiptaro- Amerikan për Zhvillim (AADF);
- në respekt të çdo eksperti dhe qytetari dhe anëtari të shoqërisë civile të Republikës së Shqipërisë, i cili përmes opinioneve, vlerësimeve dhe angazhimeve kërkon mbrojtjen dhe promovimin e vlerave tona kombëtare dhe pasurisë sonë të përbashkët;

mbështetur në **nenin 85 pika 1, 86 pika 1, 92/a, të Kushtetutës**, si Presidenti i Republikës, në cilësinë e Kreut të Shtetit dhe si përfaqësues i unitetit të popullit, kam vendosur që ky ligj duhet të rikthehet edhe një herë në Kuvend, me qëllim që kjo çështje, të marre kohën dhe vëmendjen e duhur, për t'u vlerësuar përsëri nga Kuvendi, përmes një procesi real dhe të thelluar diskutimi.

Lidhur me këtë çështje kaq të rëndësishme, si President i Republikës, vlerësoj se në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 24 të Rregullores së Kuvendit²⁷, kjo çështje, hyn pikërisht në llojin e atyre çështjeve të një rëndësie ekstremisht të

²⁷ *Neni 24*

Komisionet e posaçme

1. Kuvendi mund të vendosë krijimin e një komisioni të posaçëm për shqyrtimin dhe përgatitjen e nismave ligjvënëse, si dhe për çështje të një rëndësie të veçantë.

2. Propozimi për krijimin e komisionit të posaçëm mund të bëhet nga Kryetari i Kuvendit, nga një komision i përhershëm ose nga të paktën 7 deputetë. Kryetari i Kuvendit, brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, thërret Konferencën e Kryetarëve për të diskutuar rreth kërkesës për ngritjen e komisionit të posaçëm.

3. Kuvendi, brenda 2 javëve nga diskutimi në Konferencën e Kryetarëve, përcakton sipas propozimit të Konferencës detyrat, numrin, përbërjen dhe afatin kohor të veprimtarisë së komisionit të posaçëm.

4. Rregullat procedurale, të përcaktuara në nenet 32-41 të kësaj Rregulloreje, zbatohen edhe për komisionet e posaçme, me përjashtim të rastit kur në vendimin e krijimit të tyre përcaktohet ndryshe.

vecantë, e cila kërkon kujdes të lartë nga organet shtetërore dhe për këtë Kuvendi i Shqipërisë, duhet të miratojë dekretin e Presidentit, dhe të vlerësojë sugjerimin për ngritjen e një Komisioni të Posaçëm Parlamentar, i cili përmes një procesi të gjerë dhe solid konsultimi e diskutimi, të mund të prodhojë produktin më të mirë, e përmes një dakordësie të gjerë t'u ofrojë brezave që vijnë zgjidhjen më të mirë për Parkun Kombëtar të Butrintit dhe gjithë pasuritë të çdo lloji pjesë e tij.

Në këtë mënyrë, jo vetëm do të garantojmë zgjidhje dhe zgjedhje më të mira, por do të ishim në unison dhe me kërkesat e Parlamentit Evropian i cili në datën 19 maj 2022, ka miratuar Rezolutën²⁸ me përplot 73 pika, ku ndër të tjera, **bën thirrje që politika shqiptare të tregojë pjekuri politike në trajtimin e çështjeve me interes publik, të rrisë demokracinë, rikujton përgjegjësinë e autoriteteve qendrore dhe lokale për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje**, si dhe thekson se përmirësimi i qeverisjes, transparenca, siguria ligjore, përfshirja dhe dialogu social janë thelbësore për stimulimin e investimeve të huaja direkte dhe mbajtjen e punëtorëve të kualifikuar; bën thirrje për një përfshirje kuptimplotë të shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara në debatin mbi veprimet e politikave.

Nëse shumica në Kuvendin e Shqipërisë do të zgjedhë siç dhe ka deklaruar publikisht të rrëzojë politikisht dekretin e Presidentit të Republikës, dhe të vijojë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 50/2022, kjo nuk do t'i shërbente aspak interesave të larta të vendit dhe kombit shqiptar, por do të përkeqësonte çdo marrëdhënie të organeve të shtetit me shoqërinë civile, ekspertët, dhe qytetarët në tërësi.

Bashkëlidhur këtij arsyetimi gjenden 4 shtojca me qëndrime dhe vlerësime mbi këtë nismë legislative, me të cilat Kuvendi duhet të njihet, t'i administrojë dhe t'i shqyrtojë ato së bashku me Dekretin e Presidentit të Republikës.

Tiranë, më 20.06.2022

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Ilir Meta

²⁸ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2022-0214_EN.html